Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Shkurt 2010 • Numri: 23 • E përmuajshme



Dashuria ndaj Pejgamberit a.s.

بسم الله الرحمن الرحيم

Editorial

I nderuar lexues!

Në mjaft vargje të Kuranit përmendet fakti se Profeti i Islamit, Muhamedi (a.s.) ishte njerëzor e jo hyjnor në kuptimin e një mishërimi. Këto ajete nuk e mohojnë aspak madhështinë përparësore të Profetit të Bekuar, si më i përkryeri i qenieve njerëzore, si "xhevahiri mes gurëve" në vargun e famshëm poetik.

Pikërisht në sajë të përsosjes së mbartur prej tij, ai u ka shërbyer si shembull i përkryer brezave të myslimanëve. Nuk ka asnjë dyshim se atij iu dha nga Zoti një shquarje e atillë, që është e pazakontë dhe jo thjesht njerëzore, siç përdoret kjo fjalë sot, ndonëse teologjikisht ai nuk ishte me prejardhje hyjnore, por njeri. Nuk ka provë më të mirë të shquarjes së tij të jashtëzakonshme, sesa pagabueshmëria e tij, pra faktit që ai ishte i mbrojtur nga Zoti prej gabimit ose që ai ishte "larë" e kulluar nga engjëjt - siç dëshmon ngjarja e treguar më lart për larjen e kraharorit të tij nga melekët.

Nuk ka rrezik më të madh për myslimanët e sotëm se ai i të reduktuarit të madhështisë së mrekullueshme të Profetit të Bekuar në terma mendjengushta njerëzore, me justifikimin e jashtëm se ai ishte thjesht njeri, por duke i shërbyer në të vërtetë [me këtë reduktim] humanizmit mbizotërues të Perëndimit modern.

Fakti se Profeti i Bekuar ishte njeri nuk do të thotë se ai ishte i zakonshëm si çdo qenie njerëzore, por që gjendja njerëzore e zotëron mundësinë e madhështisë dhe plotësisë të shpalosur nga personaliteti dhe karakteri i tij.

Të përsiaturit mbi jetën, virtytet dhe arritjet e Profetit të Bekuar do të thotë të kuptohet jo vetëm madhështia e fuqisë së Zotit dhe e profetëve të tij, por edhe fakti se njerëzimi si tërësi jeton kaq poshtë nivelit të njerëzores së vërtetë. Profetët i shpalosin njerëzimit mundësinë totale të ekzistencës. Janë pikërisht ata, që e ngrenë kuptimin e fjalës "njeri" në rasën e saj më të lartë dhe njeriut s'i bëhet dot dëm më i madh sesa të reduktuarit e tyre në standardet mendjengushta dhe shpesh të papërfillshme të njeriut modern; në vend që t'i mbajnë si ideale e shembuj të përhershëm, që mund t'i ndihmojnë njerëzit ta realizojnë (të paktën në njëfarë shkalle) natyrën tërësore dhe të plotë të gjendjes njerëzore.

Ju urojmë lexim të këndshëm.

Do të lexoni:



Rashit Kyçyk /4 Pejgamberi i dashurisë

Mr. Zymer Ramadani /8 Drejt gjurmëve të Muhammedit a.s.

Abdylkadër Duguti /12 Metoda e Muhammedit a.s. për formimin e një civilizimi modern

Lavdrim Hamja /16 Momentet e fundit të Pejgamberit a.s. dhe porositë e tij

Nexhat Ibrahimi /19 Manifestimi i mevludit: domosdoshmëri kohe, jo risi e dëmshme

Sejjid Hysejn Nasr /22 Roli dhe karakteri i Profetit të bekuar

Asuman Dogru /26 Feja e fundit Pejgamberi i fundit

Ma. Artur Tagani / 29 Shkenca në islam

Rashit Kyçyk /
Pejgamberi i dashurisë
4

Sejjid Hysejn Nasr /
Roli dhe karakteri i Profetit të bekuar
22

Asuman Dogru /
Feja e fundit - Pejgamberi i fundit
26

Viti: V | Numri: 23 | Shkurt 2010

Administrator i Progresi botime:
Shuajip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor i revistës:
Ermal Nurja
ottoman-script@hotmail.com
+355 67 20 86767

Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Arjan Ymeri
Evans Drishti
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Redaktor:
Shpëtim Kelmendi

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com

Shkurt 2010

32 ***Osman Nuri Topbash /***
Dashuria ndaj Hazreti Pejgamberit a.s.

44 ***Naim Drijaj /***
Shenjë e dashurisë ndaj Profetit a.s.

46 ***Gençer Dervari /***
Obligimet e Pejgamberit a.s. sipas Kuranit

/ 30 - 31	Një Ajet - Një Hadith
Osman Nuri Topbash /32	Dashuria ndaj Hazreti Pejgamberit a.s.
Mr. sci. Flamur Sofiu /38	Një qasje juridike islame ndaj të drejtës autoriale
/41	Nëse do t'ju vinte Pejgamberi
Naim Drijaj /44	Shenjë e dashurisë ndaj Profetit a.s.
Gençer Dervari /46	Obligimet e Pejgamberit a.s. sipas Kuranit
/48	Letër Resulullahut
Mag. Ali Bardhi / 50	Jeta e Daut Boriçit sipas dokumenteve osmanë
Familja /52	Fatma binti Hattab (r.a.)
Shëndeti / 54	Shqetësimi dhe stresi i provimeve ndikon në kujtesë
Teknologji / 56	Google, plane për të dixhitalizuar të gjithë librat në qarkullim
Aktualitet / 58	Shqipëria përballë sfidës së numërimit të popullsisë së saj

PROGRESI SOTIME
www.progresisotime.com

Adresa:
L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 534
Fax: +355 22 254 533

Zyra e përfaqësimit Maqedoni
Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë:
Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:
Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor) : 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 600 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro

Pejgamberi *i dashurisë*

Rashit Kyçyk

Dashuria është një ndjenjë e pazëvendësueshme për të cilën njeriu dhe njerëzimi ka patur përherë nevojë. Njerëzit e kanë kërkuar dhe për hir të saj janë përballur me shumë vështirësi, dhe me ta gjetur, me ta ndjerë dhe jetuar kanë arritur një lumturi të pafundme.

Dashuria është pika kulminante e pjekurisë së njeriut, pika më e lartë e fesë. Pejgamberi (a.s) është një kulm në formimin individual, ndërsa Islami përbën një kulm në fe. Jo kushdo mund të arrijë në majën më të lartë, por kur e sheh atë, përpiqet të ngrihet deri atje, që pastaj të shuajë etjen nga burimi i atjeshëm dhe të shijojë kënaqësinë që i dhuron jeta.

Çdo gjë që Islami ka sjellë është e mrekullueshme. Kjo sepse ai është feja e fundit dhe çdokush e pranon këtë gjë të mrekullueshme të të qenurit e fundit. Prandaj, Kurani është libri më i mrekullueshëm, ndërsa profeti njeriu më i mrekullueshëm. Rregulli që ka vendosur islami është më i mrekullueshmi. Kjo mrekulli e rregullit mund të vlerësohet duke parë se çdo gjë është në vendin e vet, se nuk ka hapësirë boshe, se është një sistem që i jep përgjigje çdo shekulli, çdo gjeografie, çdo nevoje të njeriut dhe paralel me të i jep zgjidhje çdo detaji sado të vogël. Ja pra, Islami i është paraqitur njerëzimit si një sistem i mrekullueshëm që ka realizuar të gjitha këto gjëra, të cilat asnjë fe tjetër, asnjë sistem tjetër dhe asnjë epokë tjetër nuk ka mundur ta bëjë.

Feja dhe dashuria

Në gjuhën arabe përdoren 60 fjalë për të shprehur dashurinë dhe pjesa më e madhe e tyre përmenden në Kuran dhe synet. Krijimin e botës dhe vazhdimësinë e saj brenda një rregulli, Islami e sheh të lidhur me dashurinë. Në themel të të gjitha punëve dhe adhurimeve, në plan të parë del dashuria. Madje burimi i çdo frike në Islam është i lidhur me dashurinë. Një besimtar frikësohet dhe tërhiqet se mos e ofendojnë Allahun dhe pejgamberin dhe se mos sillet në mënyrë të papëlqyeshme ndaj tyre, pasi qëllimi i një besimtari të mirë është të bëhet një rob i mirë që e do Allahu. Prandaj, është mirë të shpëtohet nga çdo gjë që pengon dashurinë dhe të dashuruarin. Prandaj, duhet t'u bindemi urdhërave dhe ndalesave të fesë, harameve dhe hallalleve. Ndalesat dhe haramet janë shkaqet e mosdashurisë dhe rezultat i kësaj është humbja e dashurisë dhe dhimbja që mbetet pas.

Në Kuran flitet për shoqëri që e duan Allahun dhe se edhe Allahu i do ata. Ata sillen shumë modestë ndaj besimtarëve dhe me nder ndaj mohuesve. Kush lufton në rrugë të Allahut nuk frikësohet nga asnjë kërcënim dhe është njeri me karakter të fortë. (Maide, 5/54)

Në mesin e atyre që Allahu do numërohen muhsinët, të penduarit dhe të pastruarët nga gjynahet, ata të cilët e respektojnë Allahun e që mbrohen nga të këqijat dhe gjërat e shëmtuara, durimtarët, ata të cilët i mbështeten Allahut dhe të drejtët.

Secili prej tyre përbën një shkallë që nuk është e lehtë për t'u arritur dhe që mund të fitohet vetëm duke u bërë një besimtar i zgjedhur. Atëherë, për t'u bërë një njeri i dashur për Allahun, për të hyrë në mesin e tyre, duhet një përpjekje e madhe, bindje ndaj urdhërave, shmangie nga ndalesat dhe shumë sakrificë.

Besimi është shkalla e parë e dashurisë, pika e parë e referimit. Besimi është baza e njësisë në dashuri, guri themeltar për të shpëtuar nga shirku. Shirku në dashuri është më i madhi i të gjitha shirkeve dhe burimi kryesor i tij. Njësia në dashuri është thelbi i tevhidit. Çdo dashuri legjitime perceptohet mbi këtë bazë. Feja Islame i pranon të gjitha dashuritë legjitime, që janë pjesë përbërëse e dashurisë së Allahut. Pasi dashuria për profetin, për prindërit, për fëmijët janë një urdhër i Allahut. Këto lloj dashurish, ashtu siç nuk mund të dalin para dashurisë ndaj Allahut, nuk mund të jenë as ortak me të.

Pejgamberi dhe dashuria

Pejgamberi ynë e ka shprehur shumë përmbledhtazi "ësh-

të pejgamberi i dashurisë, shkalla më e fundit që mund të arrihet në dashuri, termi më i fundit i përdorur për të shprehur dashurinë është "taabud", term që shpreh atë shkallë që të bën rob me të drejtë të Zotit. Më tutje vjen shkalla "halil", e cila shpreh miqësinë e ngushtë e të vërtetë dhe njësinë e plotë në dashuri.

Siç e shprehëm më sipër, Pejgamberi (a.s) është në shkallën më të lartë të robërisë. Robëria është qëllimi i dashurisë së Allahut, shkalla e bindjes ndaj Zotit, shkalla e fundit e përuljes ndaj Tij dhe e dorëzimit me çdo gjë. Robëria është një shkallë që nuk përdoret për askënd tjetër veç Allahut dhe që i përket vetëm Atij. Robëria i bëhet vetëm Allahut. Prandaj, në suren Fatiha, thuhet: "Vetëm Ty të adhurojmë, vetëm Ty të bëjmë robëri" Allahu njofton se çdo gjynah tjetër mund ta falë përveç shirkut në adhurime dhe në robëri. (Nisa, 4/48)

Ajete të ndryshme të Kuranit njoftojnë se pejgamberi ynë është më superiori dhe më i ndershmi në shkallën e robërisë. Ja, këto janë shkallët që përcakton Allahu për robërinë e tij:

a) Në postin e përballjes ndaj kundërshtarëve dhe opozitarëve "Ai (All-llahu) është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i bëri ata shtatë qiej. Ai është i Gjithëdijshmi për çdo gjë. " (Bakare, 2/29)

b) Në shkallën Isra "Pa të meta është Lartëmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtetë, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhammedit)." (Isra, 17/1)

c) Në postin e ftuesit "Dhe se kur u ngrit robi i All-llahut ta adhurojë Atë, ata (xhinët ose idhujtarët) gati hipnin njëri mbi tjetërin për të dëgjuar." (Xhin, 72/19)

Këto ajete tregojnë përparësinë e pejgamberit në robëri, shkallën sipërore dhe postin e nderit në këtë botë dhe në ahiret.

Sipas një transmetimi të saktë, ata që kërkojnë ndërmjetësim në ditën e gjykimit sillen tek të gjithë pejgamberët e mëdhenj, duke filluar që nga Ademi. Në fund, kur vijnë tek Isaja (a. s), atyre u thonë – Shkoni tek Muhamedi (a. s), tek robi të cilit i janë falur të gjitha gabimet e kaluara. Fakti që Isaja e kujton Pejgamberin me cilësinë e "Robit" është shumë domethënës, pasi e cekëm pak më parë se sa e vështirë është të arrish në këtë post. Patën thënë se profeti ynë për të cilin besojmë se ka synuar t'u mësojë njerëzve rëndësinë e robërisë nëpërmjet konceptimit madje edhe të emrave, ka qenë nga ata që i kanë kushtuar Allahut emra të tillë si Abdullah, Abdurrahman.

Cilësia tjetër e lartpërmendur "halil" i është dhënë dy personave në botë. Ibrahimit (a.s) dhe Muhamedit (a.s) Halil është ai, dashuria dhe miqësia e ngushtë e së cilit i përket vetëm Allahut që do. Në zemrën e tij nuk ka vend për asgjë tjetër përveç dashurisë për Të. Nisur nga kjo, nuk pranon të jetë ortak me askënd tjetër. Allahu thotë "Allahu e bëri mik të ngushtë Ibrahimin" (Nisa, 4/125) Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu më bëri mik të ngushtë siç bëri edhe Ibrahimin".

Temat e dashurisë të përcaktuara në Kuran në njohjen e profetit.

Në prezantimin e Pejgamberit duke numëruar cilësitë e Tij, Kurani zgjedh fjalë mjaft kuptimplote, delikate, tërheqëse, të cilat lënë gjurmë dhe plot dashuri në mëndjen dhe shpirtin e njeriut. Kam përshtypjen se është e mjaftueshme të ceknim vetëm disa prej tyre:

1. "O Muhamed! Ty të dërguam vetëm si mëshirë për gjithë njerëzimin dhe gjithësinë." (Enbija, 21/107) Fjala mëshirë është një term qetësues për atë që e dëgjon, të hap shpirtin dhe i jep siguri bashkëbiseduesit. Kuptimet që të vijnë fillimisht në mëndje shprehin modestinë, delikatesën shpirtërore, mirësinë dhe urtësinë. Ka shumë ajete në të cilat janë përdorur këto kuptime. Prezantimi i të dërguarit të Allahut me këto cilësi ka si synim edhe besimtarët dhe jobesimtarët. Pasi mëshira përfshin të gjitha qeniet. Prandaj, edhe në ajet është thënë: "Mëshirë për gjithë botët" Të duket sikur islami është një rrebesh mëshire që bie çdo çast në tokë, ndërsa pejgamberi i dërguari i mëshirës.

2. "O Muhamed! Ne të dërguam ty vetëm si lajmëtar dhe këshillues për gjithë njerëzit." (Sebe, 34/28). Ky fakt përsëritet edhe në ajetet të tjera. Imazhi që lënë në mendjen e njeriut fjalët Lajmëtar dhe paralajmërues, janë të lidhura me njëra-tjetrën, janë përmbledhëse, janë shmangëse të rreziqeve dhe pritëse. Gjithashtu, ato kanë edhe anët e tyre dashamirëse dhe një zgjim të ndjenjës së respektit. Dallimi i këtij ajeti nga ajetet e tjera, është se ky përcaktohet me shprehjen "të gjithë njerëzimit" "Ditën që e takojnë Atë (Zotin), përshëndetja e tyre është Selam (paqe) dhe për ta ka përgatitur shpërblim të mirë. O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar përgëzues dhe qortues" (Ahzap, 33/44-45). Secila nga këto cilësi janë tërheqëse dhe influencuese për njeriun.

3. Thuaj (Muhammed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut tek të gjithë ju" (A'raf, 7/158) Të qenët i dërguar "për gjithë njerëzit", cilësi kjo e përcaktuar në Kuran, është një tipar që i përket vetëm të dërguarit mes pejgamberëve të tjerë. Kjo pasi pejgamberët e tjerë janë dërguar me gjuhën e vetë popujve dhe vetë popujve të tyre. Këtë të vërtetë e mësojmë nga Kurani (Ibrahim,. 14/4) Të qenët i dërguari i Allahut, dërguar për gjithë njerëzit, do të thotë të mbartësh një mesazh universal për mbarë rruzullin tokësor. Ky mesazh është jetëdhënës për secilin dhe i është drejtuar gjithë njerëzisë. Natyrisht që ky mesazh është Kurani. I dërguari që u ka përcjellë këtë mesazh gjithë njerëzve në mbarë botën, është një i dërguar i cili e ka lexuar atë, e ka shpallur, e ka kuptuar e ka jetuar dhe e ka praktikuar. Nisur nga këto tipare, ajeti në vijim ka shumë rëndësi: "Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, sepse All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë" (Al-I Imran, 3/31) "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun." (Ahzab, 33/21)

Këto janë disa nga veçoritë dhe tiparet dalluese të pafundme të Pejgamberi të dashurisë. Pasi Allahu i Lartmadhëruar të gjitha veçoritë e krijimit i ka mbledhur tek Ai. Të gjithë superioritetet e kësaj bote dhe të ahiretit i janë dhënë të dërguarit të Allahut. Cilësitë e tij lidhur me dashurinë janë aq të gjera, sa që nuk mjafton një shkrim, por duhet një

"Ditën që e takojnë Atë (Zotin), përshëndetja e tyre është Selam (paqe) dhe për ta ka përgatitur shpërblim të mirë. O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar përgëzues dhe qortues"

(Ahzab, 33/44-45)

libër i tëri për t'u përshkruar.

Nga dritarja e Kuranit

I dashuri i Allahut i krijuar për dashurinë e tokës dhe të qiellit... Habibullah... I dërguari i fundit i Allahut... "Hatemun-Nebijj", më i bukuri nga ata që ka krijuar Zoti. Atëherë s'ka nevojë për shumë fjalë... Le ta shohim nga dritarja e Kuranit:

*Zoti mori fjalën nga pejgamberët e tjerë për Pejgamberin e dashur. Allahu ka marrë fjalën nga pejgamberët që ata ta besonin, t'u bindeshin dhe ta ndihmonin. Falë Zotit u dhashë libër dhe urtësi, do vijë një pejgamber që t'u vërtetojë atë ç'keni, atij do t'i besoni patjetër dhe do ta ndihmoni, a e pranuat këtë akt? E besuam, patëm thënë dhe e dëshmuam. Unë jam dëshmitar së bashku me ju (Al-I Imran, 81)

*Në librat e ardhur më parë ka njoftuar cilësitë e Tij

*Kur u japim libër atyre, e njohin Muhamedin siç njohin bijtë e tij. Megjithëkëtë, një grup prej tyre të vetëdijshëm e fshehin këtë të vërtetë. (Bakare, 146)

*Zoti e ka krijuar atë si myslimanin e parë (Zumer, 12; En'am, 164) të fundit e pejgamberëve (Ahzap, 40) "Ne të zbritëm Ty vetëm si mëshirë për botët" (Enbija, 107) duke e prezantuar si të tillë e ka prezantuar edhe si profet të Mëshirës dhe të Dhembshurisë (Tevbe, 128)

*Ai është dërguar për gjithë njerëzimin, nëpërmjet ajetit "Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Sebe, 28) Ai vë në dukje se profetësia përfshin gjithë njerëzimin, dhe duke thënë "Po All-llahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre dhe All-llahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (istigfarë)." (Enfal, 33) e ka bërë atë për bashkësinë një burim sigurie ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve.

*Zoti është betuar në jetën e tij (Hixhr, 72) dhe në qytetin e tij (Beled, 1-2) e ka ndaluar ta thërrasim atë me emër, (Nur, 63) e ka këshilluar të jetë i sjellshëm dhe mos ta nxjerrë zërin më shumë se të tjerët (Huxhurat, 3), duke na mësuar kështu edhe edukatën e mirë.

*E ka cilësuar atë si një kandil përherë ndriçues (Nisa, 80), i ka njoftuar besimtarët se duhet të jetë më i dashur se vetja e tyre, ndërsa gratë e tij janë nënat e besimtarëve (Ahzap, 6)

* Bindjen ndaj Tij e ka shpallur si bindje ndaj Zotit (Nisa, 80), përuljen ndaj Tij si përulje ndaj Zotit, (Fetih, 10) fitimi i dashurisë ndaj Allahut arrihet vetëm me bindje ndaj tij dhe kështu edhe gjynahet tona do të falen (Al-I Imran, 31) Madje ka theksuar se besimi nuk mund të pranohet pa të dhe nëpërmjet ajetit "O ju që besuat! Besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij!"(Nisa, 136), ka theksuar se besimi ndaj Allahut bëhet bashkë me besimin ndaj Tij.

*Allahu dhe melekët i kanë dërguar përherë salate dhe selame, duke urdhëruar edhe besimtarët që t'i dërgojnë vazhdimisht salate dhe selame. ((Ahzap, 56) Për të dhe atë që i është zbritur, janë të mjaftueshëm Allahu dhe meleketë (Nisa, 166), thënë ndryshe shpallja është vulosur.

* Ka dëshiruar nga njerëzit të mos jenë të pavetëdijshëm, pasi atë e ka bërë një shembull shumë të mirë për ne (Ahzap, 21). Kush insiston t'i dalë kundër, do të turpërohen si ata të mëparshmit (Muxhadele, 5). Këta janë më të poshtërit (Muxhadele, 20). Si dënim për ta do jetë zjarri i xhehenemit (Xhin, 23)

*Duke njoftuar besimtarët se nuk mund ta duan dikë që e ka bërë armik Allahun dhe pejgamberin, qofshin këto babai, biri apo farefisnia (Muxhadele, 22), që duhet të frikësohemi nga Allahu e t'i besojmë profetit dhe mëshirës së tij (Hadid, 28), na mëson se duhet t'i bindemi plotësisht profetit të mëshirës dhe ta plotësojmë veten me dashurinë për të.

Zoti na bëftë prej atyre robërve të cilët u janë dorëzuar të dërguarit dhe që mundohen të jenë pjesë e bashkësisë së tij. Amin!

Drejt gjurmëve të Muhammedit a.s.

Mr. Zymer Ramadani

Çdo krijesë e lindur, në një aspekt apo tjetër është kandidat për vdekje, qoftë herët apo vonë. Këtë krijesë së cilës ia dha frymën Allahu xh. sh. askush nuk arriti ta edukojë në shkallën më të lartë morale, shpirtërore e as mendore, përpos këshillave dhe urdhrave të Atij që e Krijoi. Për këtë shkak, duke qenë se individi ka nevojë të pashmangshme për një kulturë dhe jetë të shendoshë, atij iu dërgua libri me të cilin do të udhëzohet, si dhe pejgamberi me të cilin do të këshillohet...

Ka disa shekuj që i dashuri i Allahut, Muhammedi a. s. u nda nga mesi i shokëve të tij, një ndarje që e tronditi të gjithë gjithësinë dhe lëndoi shumë zemra që jetonin së bashku në atë kohë. Kjo ndarje e të dashurit tonë Muhammed Mustafasë la mbrapa një varg punësh, për të cilat me kalimin e ditëve, viteve dhe shekujve ndihet nevoja e madhe e tij. Mirëpo, edhe pse i dashuri ynë Muhammedi a. s. nuk qëndron më fizikisht në mesin tonë, etjen që ne kemi për të e shuajmë duke iu përmbajtur veprave dhe këshillave hyjnore që na la amanet deri në kiamet. Ky amanet, për herë të fundit u përsërit në Hutben e Lamtumirës, ku përpos shumë këshillave dhe porosive që na dha, ndërmjet të cilave mund të përmendim kujdesin ndaj fqinjit, kujdesin ndaj prindërve, bashkëshortëve, jetimeve etj., si vulë të të gjithave ai tha: Kur'ani dhe Sunneti – këto dyja po u lë amanet; nëse veproni në bazë të këtyre, kurrë nuk do të humbni, kurrë nuk do të pikëlloheni dhe kurrë nuk do të jeni të etur për diçka.

Duke e ditur se Muhammedi a. s. ishte vetëm Pejgamberi i Allahut, ai nuk la pas vetes ndonjë zëvendës, as nga familja e tij e ngushtë, dhe për këtë qëllim Allahu thekson se ai ishte vetëm Pejgamber e jo prind i ndokujt nga njerëzimi:

"**Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshëm për çdo send**".(Ahzab, 33/40) ;

Të gjithë pejgamberet e mëparshëm ishin të dërguarit e All-llahut dhe udhëzuesit për në rrugën e Tij. Kurse sa na përket ne njerëzve, jemi në një jetë kalimtare për t'u sprovuar dhe për t'i bërë adhurimin e duhur All-llahut të Madhëruar. Mirëpo kjo sprovë apo provim i jetës nuk ka të bëjë vetëm me njohuri dhe dituri, por është një sprovë e ndërlidhur me veprat, sjelljet, moralin dhe jetën e njeriut në tërësi. Për ta zbukuruar këtë sistem dhe për të pasur

suksese në këtë provim të rëndë të kësaj jete, dhe për ta bërë sa më mirë adhurimin ndaj All-llahut, ne si krijesa njerëzore kemi nevojë për një mësues, një udhëzues dhe predikues të dërguar nga ana e Krijuesit të madhëruar, All-llahut xh. sh. Për këtë nevojë njerëzore, është dërguar margaritari i fundit i vargut të pejgamberëve për mbarë njerëzimin, Muhammed Mustafaja (Allahu qoftë i kënaqur nga ai).

"**Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur**". (Ali Imran 3/146) Në mënyrë që ta kuptojmë këtë "mirësi Hyjnore", kërkohet pikësëpari ta njohim atë, thelbin e jetës së tij dhe jetën e tij. Sa më shumë që ne mësojmë dhe lexojmë për të, aq më shumë do të na shtohet dashuria dhe nevoja ndaj tij. Ngase nga leximi që do bëjmë për të, do të shohim se ai asnjëherë në jetën e tij nuk ka hidhëruar e as ka nënçmuar ndokënd.

"Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur".
(Ali Imran 3/146)

Sjelljet e tija ishin aq të shkëlqyeshme, sa që kur ishte me fëmijët, lozte sipas kërkesave dhe dëshirave të tyre, i përkëdhelte, i këshillonte, u jepte diçka për t'i gëzuar. Kur ndahej nga ata dhe takohej me moshatarët e tij, po ashtu përshtatej edhe me ata, prandaj asnjë libër nuk shkruan që ai të ketë lënduar dikë. Duhet të theksojmë se gjatë gjithë kësaj historie të madhe, kanë ardhur dhe shkuar shumë e shumë njerëz të mençur e të ditur, por të gjithë kanë humbur pas vdekjes së tyre. Emrat e tyre mbetën ndoshta vetëm nëpër disa libra e fletushka... Asnjëri nga ata nuk ka fituar një dashuri sikurse ajo që fitoi Muhammedi a. s. nga shokët dhe pasuesit e tij. Pikërisht për këtë shkak, ata janë hedhur poshtë dhe është lartësuar vetëm krijesa më e mirë e Allahut, Muhammedi a. s. Në këtë kontekst, Allahu xh. sh. thotë: "**Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde**?" (Inshirah, 94/4)

Personaliteti i Muhammedit a. s. ndikoi thellë në zemrat e myslimanëve, ndaj sot të gjithë myslimanët mundohen që familjen dhe rrethin e tyre ta edukojnë brenda suazave dhe koncepteve të këshillave të tij. Bota moderne, e cila përparon çdo ditë e më tepër, u ka ofruar të gjitha moshave njerëzore mundësi të mëdha që të jenë sa më të qetë në jetën e tyre. Janë bërë shumë shpenzime që të arrihet deri tek diçka e "vlefshme", që njeriu të mos ndjejë nevojë për asgjë. Por është realitet se një pjesë e njerëzve, edhe pse i kanë të gjitha, janë mërzitur nga përdorimi i tyre. Mirëpo, përderisa dikush noton në çdo mirësi dhe luks, e dikush tjetër mbytet në mënyrë që të krijohet vend dhe rreth sa më i mirë për të tjerët, atëherë problemi rritet edhe më tepër. Shumëkush mund të jetë i pasur ekonomikisht, dhe po ashtu shumëkush mund ta edukojë brezin e tij me programe të teknologjisë dhe metodave të reja të shkollimit. Por, përderisa njerëzimi është lëshuar drejtë luksit dhe pasurisë, për fat të keq brezi ynë është duke përjetuar një shkatërrim dhe një tronditje psikike e shpirtërore. Kjo ndodh për shkak se jemi përqendruar vetëm në pamjen dhe aspektin e jashtëm të ndërtimit të brezit, duke harruar se në trupin e tyre gjendet zemra, e cila ka nevojë për edukim dhe mësim, nevojë kjo që as moderniteti e as paraja nuk mund t'ia plotësojnë.

Problemi qëndron se shpirtërisht ne i kemi anashkaluar gjërat themelore të jetës. Njeriu është një krijesë që gjatë gjithë jetës ka nevojë për t'u mbështetur në një fuqi absolute, ka nevojë për ushqim shpirtëror, ka nevojë për kalitje të zemrës dhe shpirtit. Për fat të keq, ky ushqim shumë i nevojshëm i shpirtit, nuk kërkohet tek mjeku i zemrave, tek Krijuesi i tyre, por kërkohet në vende dhe në gjëra të degjeneruara. Është anashkaluar edukimi ynë moral dhe fetar, ndërkohë që Pejgamberi a. s. na ka këshilluar se po t'u përmbaheni këtyre porosive, kurrë nuk do humbni.

Urgjentisht duhet të bëjmë një llogari në vete, për ta gjetur rrugën që na tregoi Muhammedi a. s., sepse përndryshe, humbjet janë të mëdha, problemet janë të tmerrshme. Ne kemi nevojë të madhe që në shtëpitë tona të mësohet Pejgamberi ynë, të veprohet dhe punohet sipas asaj që ai ka porositur. Sa mirë e përshkruan Kur'ani nevojën për

"Zoti ynë, bëna neve të dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, na bëj njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) dhe falna neve, vërtetë Ti je që fal, je mëshirues!"



pejgamber, nëpërmjet lutjes që bën Ibrahimi a. s. me të birin Ismailin a. s. për brezin e tyre:

"Zoti ynë, bëna neve të dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, na bëj njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) dhe falna neve, vërtetë Ti je që fal, je mëshirues!". Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t'i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S'ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshmi. (Bekare, 2/128, 129)

Nëse ndalemi dhe shikojmë ata të cilët e pasuruan zemrën dhe shpirtin e tyre me mësimet Kur'anore, gjithmonë do të shohim një bukuri dhe ndricim në fytyrat e tyre. Edhe pse Muhammedi a.s. jetoi disa shekuj më parë, ai na la pas programin e duhur, sepse programi i tij nuk ishte përpiluar nga truri i njeriut, por ishte hyjnor. Fama dhe personaliteti ti tij ishin të larta si para lindjes ashtu edhe pas vdekjes së tij. Përderisa për ardhjen e tij, paralajmëruan pejgamberet e më të hershëm, duhet të bindemi vërtetë se një edukim i brezit dhe një nevojë për Pejgamberin është urgjente dhe e patjetërsueshme:

"***Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!"***..." (Saff, 61/6)

Ardhja e tij tek ne është mëshirë, begati dhe privilegj. Ndërtimi i jetës sipas porosive-haditheve që na ka lënë ai, na shpie në një kopsht lulesh të kësaj bote, dhe në kopshtin e xhenetit të ahiretit. Nëse sot dikush mundohet ta mbush trurin e njeriut me gjëra të ndryshme, ai zemrën e tij e len të zbraztë, por kur një ditë t'i vijë momenti i ndarjes nga kjo botë, si do të dalë para Allahut pa vepra të mira, pa adhurim dhe pa besim? Në anën tjetër, Kur'ani thërret në lumturi të kësaj bote dhe të botës tjetër, ndaj Allahu, si mësues dhe sqarues të ajeteve Kur'anore dhe shembull më të mirë, na e dërgoi Muhammed Mustafanë:

"***Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët***". (Tevbe, 9/128) Pastaj: "***E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat***". (Enbija, 21/107)Lidhur me këtë çështje, edhe Muhammedi a. s. thekson: "*Unë jam dërguar si mëshirë e jo si mallkues*". (Muslim, El-Birr, 87)

Se sa i dha rëndësi Pejgamberi a.s edukimit të shoqërisë dhe brezit të ardhshëm, këtë e vërejmë edhe nga një thënie tjetër e transmetuar në disa versione: *"Unë u dërgova për të përmirësuar virtytet e moralit"* apo *"Jam dërguar për t'u mësuar sjelljet dhe moralin"*. Sido që të jetë, butësia dhe shkëlqimi i moralit të Pejgamberit a. s. shpoi thellë zemrat e ndrydhura dhe të ndryshkura nga mëkatet dhe sjelljet e këqija, qëkurse ai filloi predikimin e tij të parë në Mekkë. Ky ndryshim u shfaq qysh në ditët e para, sepse ai gjithkujt i dha vlerën dhe të drejtën që e meritoi; edhe njeriun më të varfër ekonomikisht e ngriti dhe lartësoi në nivelin më të lartë të moralit. Plakun e bëri të ri, kurse të riun e shëroi nga sëmundjet e zemrës dhe urrejtjet që ekzistonin midis fiseve.

"**Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun**". (Ahzab 33/21)Pejgamberi ynë i dashur është shembulli më i mirë dhe më i sinqertë në çdo fushë të jetës sonë. Ai është filizi i lumturisë dhe burimi i dashurisë së zemrave tona. Një nga obligimet dhe virtytet e tij fisnike është se ai e kishte balancuar moralin e tij të lartë me thëniet e tij të ndershme. Kështu që nuk mund të hasim kontradikta mes thënieve dhe veprave. Ai Pejgamber që u gurëzua nga popullata e qytetit Taif, nuk i mallkoi ata, e as nuk tha ndonjë fjalë fyese ndaj tyre, por hapi butësinë e zemrës, ndërsa njeriut që e gjuajti me gurë Pejgamberi ia ktheu një buqetë lulesh me këtë lutje fisnike: "O Allah, nëse Ti do e shkatërron këtë popull, por nuk do të mbetet asnjë rob nga këta që do të adhurojë ty." Po ashtu, vazhdoi duke thënë se ata nuk e kanë kuptuar të vërtetën, dhe për këtë shkak veprojnë kështu. Por sot, sa jemi duke e gurëzuar ne atë? Sa jemi duke e fyer ne atë dhe sa jemi duke shpenzuar për uljen e personalitetit të tij? Çdo individ e di më së miri këtë realitet të hidhur... Mirëpo, aty ku flitet për të dhe sjelljet e tij, mu aty lulëzojnë tufat e luleve që aroma e të cilave nuk largohet, pa marrë parasysh se ku shpërndahen këto lule.

"Unë u dërgova për të përmirësuar virtytet e moralit" apo "Jam dërguar për t'u mësuar sjelljet dhe moralin"

Për mospajtime të fiseve dhe mendimet e ndryshme, pikërisht kur është fjala për çështje fetare e morale dhe për ngritjen e nivelit të popullit, duhet t'u kthehemi patjetër këshillave të tija, sepse ato janë këshilla dhe ligje të pathyera asnjëherë. Në këtë kontekst, All-llahu thotë: "***...Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtroni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë***". (Nisa, 4/59)

Sa i përket nevojës së madhe që kishin myslimanët e trevave tona për një edukim të brezit, bazuar në edukatën dhe civilizimin që shpërndau i dashuri i Allahut xh. sh. nëpër të gjithë botën, shohim një varg dhe një zinxhir shkrimesh që u shkruan në kohërat më të vështira për të. Këto shkrime nuk mund të mohohen, ngase në thelb kishin dashurinë e flaktë ndaj personalitetit të Muhammedit a. s. Kjo dashuri u rrit edhe më tepër kur populli filloi të kuptoi nga afër civilizimin që ai kishte ndërtua. Nuk mbetën duarkryq të ashtuquajturit *bejtexhi,* të cilët në kohërat më të vështira u bënë pasqyrë e moralit dhe personalitetit të tij për njerëzit e këtyre zonave.

Përsëri, kur ndalemi dhe shikojmë edhe më gjerë civilizimin dhe edukatën që solli ai, që nga lindje e deri në perëndim – në të katër anët e botës, vëmë re se është duke i dhënë dritë e jetë atyre që përqafuan këtë moral. Po, ata u ngritën dhe vazhdojnë të lartësohen në një shkallë më të lartë të moralit, sepse nevoja për të dhe për këshillat e tij është duke u ndjerë çdo ditë e më tepër. Njohja e Pejgamberit a. s. dhe dashuria për të, është lumturia më e madhe. Jeta e tij është e mbushur plot me shembuj për ne, ngase ai kërkonte nga njerëzit që të hiqnin dorë nga gënjeshtra, vjedhja, mbytja e njerëzve, pirja e alkoolit, bixhozi, dëmtimi i të tjerëve dhe nga ndotja e ambientit. Të gjithë duhet të vëllazërohemi dhe të edukohemi, ashtu sikundër ai i vëllazëroi dhe edukoi fiset në qytetin e Medinës qysh në ditët e para të Islamit.

Metoda e Muhammedit a.s. për formimin e një civilizimi modern

Abdylkadër Durguti

Problemi kryesor i cili e preokupon njeriun në tërë ekzistencën e tij, është pa dyshim moderniteti dhe integrimi i tij në jetën bashkëkohore. Me modernitet nënkuptojmë një periudhë kohore të rilindjes, përmirësimit, përparimit, zhvillimit etj. Të kundërtën e kësaj, pra periudhën kohore të cilën lënë mbrapa, njerëzit e emërtojnë koha e injorancës, koha primitive, koha e prapambetjes etj. Mirëpo, me periudhë moderniteti nuk duhet kuptuar po ashtu shkëputja nga feja dhe morali njerëzor. Sigurisht, nuk duhen kuptuar as përpjekjet për të hyrë nën sundimin e egoizmit dhe materializmit.

Besimi është faktori kryesor i shoqërisë, për tu primitivuar apo modernizuar, gjë të cilën mund ta mësojmë nga historia njerëzore: përderisa besimi dhe jeta shoqërore është e shëndoshë, kjo do të thotë se ndryshimi dhe modernizimi kanë korrur suksese. Në rastet kur ka humbur ekuilibri ndërmjet besimit dhe shoqërisë së shëndoshë, popujt kanë mbetur vazhdimisht nën ndikimin e jetës primitive.

Gjatë historisë njerëzore pejgamberët luajtën rolin kryesor pikërisht në formimin e ekuilibrit mes besimit dhe jetës së shëndoshë bashkëkohore. Roli i pejgambereve ishte që me (vahjin) frymëzimin që e morën

nga Allahu xh.sh., të formonin ekuilibrin në mënyrë praktike ndërmjet fesë së Allahut dhe jetës shoqërore e bashkëkohore. Qëllimi i tyre parësor qëndronte në të të qenët shembull për popullin e tyre, lumturi për jetën e tyre të kësaj bote dhe jetën e amshueshme, pra për ta shpëtuar popullin nga të gjitha problemet shoqërore, për ta përmirësuar jetën e tyre, duke e kaluar nga jeta primitive në jetë moderne, pra në jetën zhvilluese dhe integruese brenda një shoqërie të shëndoshë. Këtë qëllim, Shuajbi a.s. e shprehu kështu para shoqërisë së tij: *"... unë nuk dua tjetër vetëm të "përmirësoj" aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e Alllahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm te Ai jam i drejtuar." (Hud, 11/88)* Ky ishte qëllimi parimor i pejgambereve, për ta përmirësuar dhe modernizuar jetën shoqërore. Ata që e pranuan këtë modernizim u quajtën edhe "gjenerata e artë", ndërsa ata që nuk e pranuan përmirësimin mbetën primitivë dhe u ndëshkuan nga Allahu ndaj kësaj injorance, sikurse u ndëshkua populli Ad, Themud, Lut Sebe, Medjen etj.

S'ka dyshim se në historinë njerëzore dhe në atë të religjioneve, shohim në rend të parë Muhamedin a.s. i cili korri suksese në përmirësimin dhe modernizimin shoqërisë së tij. Faktori kryesor i suksesit tij vlerësohet për shkak të kohës dhe vendit që jetoi. Ky modernizim i tij la gjurmë edhe në gjeneratat që ishin pas tij. Suksesi i tij vlerësohet edhe më tepër, kur shikojmë kohën kur ai jetoi, sepse vendi dhe koha kur ai kaloi fëmijërinë dhe rininë e tij u vlerësua si koha e "injorancës", një civilizim primitiv kur amoraliteti ishte në nivel të lartë, ku nderi i njeriut ishte i nëpërkëmbur, ku zemrat dhe logjika ishin zhvlerësuar nga verbëria e zakoneve, nga traditat dhe besimet e kota. Me fillimin e periudhës moderne u shkatërrua simboli i prapambetjes dhe u krijua një shoqëri e re, një civilizim modern i cili ishte model edhe për të tjerët. Kjo është arsyeja pse thamë se Muhamedi a.s. zë vend të parë në historinë njerëzore dhe në atë të religjioneve për modernizimin e një shoqërie.

Parimet kryesor për zhvillimin apo modernizimin e shoqërisë janë:

1. Burimi i shëndoshë i diturisë.

2. Parashikimi i shëndoshë për të ardhmen e shoqërisë.

Këto janë dy cilësitë që e bëjnë Muhamedin a.s. të dallohet nga udhëheqësit e tjerë. Përpjekja dhe qëllimi i tij për modernizimin prirej nga pikëpamja e frymëzimit për të rritur standardet e jetës dhe për lumturinë e jetës së amshueshme. Burimi i tij i diturisë ishte pa diskutim i shëndoshë, një dituri e vërtetë, apo siç është

"... unë nuk dua tjetër vetëm të "përmirësoj" aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm te Ai jam i drejtuar."

(Hud, 11/88)

e njohur në literaturën islame "vahji" (frymëzimi). Ky burim i diturisë vinte nga krijuesi i gjithësisë, nga Allahu xh.sh., i Cili nëpërmjet engjëllit e frymëzoi Muhamedin a.s.

Përpjekja e Muhamedit a.s. ishin për të formuar një shoqëri të shëndoshë nga pikëpamja e vahjit, ku edhe vetë vahji ishte një periudhë moderne kohore, sepse ai vazhdoi 23 vite radhazi. Kur'ani zbriti 23 vite me radhë, për të zgjidhur problemet që kishte shoqëria gjatë kësaj kohe. Zakonet dhe traditat që përputheshin me jetën moderne, Kurani i la ashtu siç ishin, ndërsa ligjet e jetës primitive i zëvendësoi shkallë-shkallë me ligjet e jetës moderne. Kështu që, përveçse ishte burimi i diturisë së shëndoshë, Kurani ishte po ashtu edhe udhërrëfyes i shoqërisë në integrimin modern.

Me forcën që e mori nga burimi i diturisë, vahjit, Muhamedi a.s arriti të analizonte gjendjen e shoqërisë dhe të ndërtonte një civilizim modern. Historia dëshmon se nga burimi i shëndoshë i diturisë dhe nga aftësia e tij, ai arriti ta nxirrte shoqërinë e tij nga errësira në të cilën qe zhytur dhe ta udhëhiqte drejt një drite civilizuese moderne. Këtë sukses e arriti me zhvillimet dhe modernizimet, duke filluar me edukim, arsim, zhvillim ekonomik, ushtarak, tregti, ndërtimtari etj. Motoja e tij modernizuese ishte: "për myslimanin është humbje nëse i kalon dy ditë të njëjta".

Me këtë metodë, gjatë një periudhe të shkurtër 23-vjeçare, Kurani u bë shembull global me një shoqëri dhe besim të shëndoshë. Kjo shoqëri nuk imitoi gabimet e paraardhësit e tyre por dhe nuk fshiu çdo gjë të trashëguar nga paraardhësit. Me një logjikë të shëndoshë i analizoi të gjitha gjërat, la pas dore ato primitivet dhe u përqendrua te gjërat moderne dhe civilizuese, duke vazhduar rrugën drejt një integrimi të vërtetë.

Kjo është shoqëria e cila u cilësua si "Shoqëri e artë"; ajo jetoi me Muhamedin a.s., por edha disa gjenerata të tjera që ishin pasardhësit e tyre e kuptuan rolin dhe shembullin e Kur'anit për modernizimin, ashtu që edhe ata e vazhduan këtë civilizim të vërtetë. Kjo vazhdoi deri kur gjeneratat e reja e braktisën këtë modernitet dhe u mashtruan nga mendimet statike, të palëvizshme, duke e lënë pas dore zhvillimin, përparimin dhe modernizimin.

Rrënjët e modernizimit të cilat i vuri Muhamedi a.s., vazhduan pesë shekuj radhazi. Ky është shembull për ringjalljen e myslimanëve dhe për të shpëtuar nga gjendja në të cilën këta myslimanë gjinden sot. Për të shpëtuar nga kjo përmbytje politike, ekonomike, shoqërore dhe nga mendimet statike, duhet të vëmë në qendër të mendimeve frymëzimin e Muhamedit a.s. dhe metodën e tij për rilindjen e një jete moderne dhe civilizuese.

Që të lulëzojë kjo shpresë, së pari duhet filluar nga "Ihja-i Ulumi'd-Din" modernizimin apo reformat e shkencave fetare. Nuk duhet të tregohemi paragjykues, duke pohuar se modernizimi i shkencave fetar është edhe modernizimi i fesë. Jo, sepse Islami nuk ka nevojë për t'u modernizuar. Me themelet që ka, Islami është në gjendje të vazhdojë të jetë modern, por myslimanët duhet të jenë në gjendje t'i përcjellin hapat e tij për modernizimin. Qëllimi i modernizimit është të njihen dhe mësohen shkencat islame, që të mund t'iu përgjigjen vendit dhe kohës.

Kjo thirrje nuk është thirrja e parë për këtë lloj reforme. Dijetarët islamë e kanë përsëritur këtë kah moti.

Për këtë mund të marrim shembull dijetarin Islam Imam Gazaliu, i cili me emrin e tij të përmendur në lidhje me reformën e shkencave islame pati botuar një vepër që ndikoi tek shumë dijetarë, edhe tek burokracia, për modernizimin e shoqërisë apo udhëheqësisë islame. Mirëpo rrobat që qepi ky dijetar i madh tashmë kanë mbetur të ngushta për myslimanët, sepse bota myslimane është zgjeruar dhe rritur, teknologjia është duke u zhvilluar dita-ditës, jeta shoqërore e myslimanëve ka ndryshuar, arsye për të cilën bota myslimane ka nevojë për një Gazali numër dy që t'i përtërijë shkencat islame.

Duke marrë shembull Gazaliun, duhet theksuar se reformat nuk bëhen tek Kur'ani i cili është burimi i shkencave islame, sepse baza e vet islamit është Kur'ani. Po ashtu nuk vihen në diskutim reformat në lutjet, adhurimet apo në lidhjet mes njeriut dhe Allahut. Po ashtu, edhe parimet morale që vuri Kur'ani nuk ndeshen me natyrën morale njerëzore, prandaj nuk vihen në diskutim për t'u ndryshuar. Një moral të cilin nuk e pranon Kur'ani, ai moral nuk ka vlerë as për trupin e njeriut as për lumturinë e shpirtit.

Nuk vihet në diskutim as të flitet për parimet themelore të fesë dhe për reformat e tyre. Përkundrazi, është shoqëria ajo që duhet të modernizohet duke u bazuar në këto parime islame. Prandaj, qëllimi i reformave apo modernizimi nuk është në bazat e fesë apo në fe, por në kulturat shoqërore të cilët ushqehen nga feja.

Obligimi i besimtarëve është që të mund të arrijnë ta jetojnë fenë në çdo kohë dhe vend. Po ashtu, obligim i myslimanëve është t'i reformojnë parimet që janë jashtë besimit, adhurimit, moralit etj. Obligimi parimor është të ndiqen hapat e zhvillimit dhe modernizimit në fusha të ndryshmë, duke filluar që nga arti e deri tek arkitektura, që nga edukimi e deri tek arsimi, që nga metodologjia e deri tek të menduarit e shëndoshë. Sepse myslimanët duhet të marrin pjesë në çdo perspektivë të zhvillimit të jetës shoqërore. Islami nuk na obligon

ta jetojmë jetën ashtu siç ishte para XV shekujsh, që në vend automobilit t'u hipim kuajve apo deveve, të mos e përdorim teknologjinë e sotme, të mos e përdorim lugën për ushqim etj. Islami kërkon nga myslimanët ta jetojnë jetën moderne rreth kornizave të Islamit, pra të bëjmë jetë Islame të udhëhequr nga parimet me të cilat është obliguar Muhamedi a.s., pa marrë parasysh vendin, kohën, kulturën apo racën. Qëllimi ynë ishte që të theksonim se vahji dhe themelet që ai i vuri nuk është e nevojshme të kenë ndonjë ndryshim, por shkencat dhe metodologjia, ato të cilët luajnë rol për ta kuptuar vahjin, janë të nevojshme për zhvillim dhe modernizim.

Momentet e fundit të jetës së Pejgamberit (a.s.) dhe porositë e tij

"O njerëz, jepuni selam të gjithë atyre që do më ndjekin nga ymeti im deri në ditën e Kijametit".

Lavdrim Hamja

Përpara se Pejgamberi (a.s) të ndërronte jetë, ai bëri haxhin e lamtumirës. Gjatë këtij haxhi zbriti ajeti kuranor: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe". (Maide: 3). Ebu Bekri (r.a), pasi e dëgjoi ajetin qau. Njerëzit e pyetën se për çfarë po qante, pasi edhe ky ajet është si gjithë ajetet e tjera që i kanë zbritur të Dërguarit (a.s). Tha: "Ky ajet ka për qëllim Pejgamberin (a.s)".

Nëntë ditë përpara se i Dërguari i Allahut të ndërronte jetë, zbriti ajeti i fundit nga Kur'ani famëlartë: "Dhe ruajuni një dite kur të ktheheni te All-llahu, dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi". (Bekare: 281). Gjendja e Pejgamberit (a.s) filloi të rëndohej. "Dua të vizitoj dëshmorët e Uhudit" - u shpreh Pejgamberi (a.s). Ai qëndroi përpara varrezave të dëshmorëve të Uhudit dhe tha: "Es-selamu alejkum, o dësh-

morë të Uhudit. Ju na parapritë, por edhe ne inshaAllahu do të vimë pas jush, madje edhe unë do të vi pas jush". Gjatë kthimit prej varrezave, i Dërguari i Allahut qau. Njerëzit e pyetën: "Përse po qan o i Dërguar i Allahut"? Ai (a.s) tha: "Sa më ka marrë malli për vëllezërit e mi!". Njerëzit e pyetën: "A nuk jemi ne vëllezërit e tu?" Tha: "Jo, ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit e mi janë njerëz, të cilët do të vinë pas meje, më besojnë mua, por pa më shikuar me sy".

Tre ditë përpara se të ndërronte jetë, gjendja e tij u rëndua shumë. Një ditë u përpoq të lëvizte nga shtrati i sëmundjes, por nuk arriti të ngrihej. Atëherë iu afrua Aliu (r.a) dhe Fadël ibn Abbas (r.a). E mbartën dhe e çuan te dhoma e Aishes (r.a). Ishte hera e parë që sahabet e shihnin të Dërguarin e Allahut në këtë gjendje, prandaj dhe filluan të pyesin: "Çfarë i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut, çfarë i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut". Pastaj njerëzit filluan të grumbullohen.

Pejgamberin (a.s) filluan ta mbulonin djersët, aq sa Aisheja (r.a) tha: "Nuk kam parë kurrë asnjeri gjatë jetës sime të mbulohet në djersë në këtë formë. Merrja dorën e Pejgamberit (a.s) dhe fërkoja fytyrën e tij, sepse dora e tij ishte më e mirë dhe më bujare se dora ime. E dëgjoja duke thënë: "La ilahe il'lallah. Me të vërtetë vdekja ka momente të vështira".

Aisheja (r.a) thotë: "Gjatë kësaj kohe, në xhami u shtuan zërat dhe bisedat për gjendjen e rëndë të Pejgamberit (a.s)". I Dërguari i Allahut pyeti: "Çfarë janë gjithë këto zëra?" I thanë: "O i Dërguar i Allahut, njerëzit kanë frikë për ty". Tha (a.s): "Më ndihmoni t'u dal përpara njerëzve". E ndihmuan dhe ashtu, duke qenë në atë gjendje, ai u ngjit në minber.

Kjo është hytbeja dhe këto janë fjalët e fundit të të Dërguarit të Allahut: "O ju njerëz, shoh se jeni të frikësuar për mua". Thanë: Po, o i Dërguar i Allahut. Tha: "O ju njerëz, takimi juaj me mua nuk është në dynja, takimi juaj me mua është te Haudi *(vendi ku besimtarët do të pinë ujë në ditën e gjykimit)*. Pasha Allahun, më duket sikur jam duke e parë që nga ky vend. O njerëz, pasha Allahun nuk kam frikë varfërinë tuaj, por kam frikë këtë botë *(pasurinë)*, në të cilën ju do të garoni me njëri-tjetrin, ashtu siç kanë garuar popujt e mëparshëm dhe kjo botë do t'iu shkatërrojë juve ashtu siç i ka shkatërruar ata".

Pastaj tha: "O ju njerëz, kijeni frikë Allahun, kijeni frikë Allahun për namazin tuaj!" E përsëriti disa herë.



"O njerëz, kijeni frikë Allahun për gratë tuaja, kijeni frikë Allahun për gratë tuaja. Ju porosis të silleni mirë me gratë!"

"O njerëz! Allahu (xh.sh) i dha një njeriu për të zgjedhur në mes të kësaj bote dhe asaj që ndodhet tek Allahu. Ai zgjodhi atë që ndodhet tek Allahu". Askush nuk e kuptoi qëllimin e kësaj fjale. Ai kishte për qëllim veten e tij. Ebu Bekri (r.a) ishte i vetmi që i kuptoi këto fjalë, prandaj dhe filloi të qante. U ngrit në këmbë dhe e ndërpreu Pejgamberin (a.s) duke thënë: "T'u bëfshim fli ty me baballarët tanë, nënat tona, me fëmijët tanë, gratë tona, me pasurinë tonë! Kështu vazhdoi të përsëriste gjithnjë. Njerëzit e vështruan me habi Ebu Bekrin, që po ia ndërpriste fjalën të Dërguarit të Allahut. Pejgamberi (a.s) filloi ta mbrojë Ebu Bekrin përpara njerëzve, duke thënë: "O ju njerëz, lëreni Ebu Bekrin, sepse nuk ka njeri prej jush, i cili ka kontribuuar për ne dhe të mos ia kemi shpërblyer, përveç Ebu Bekrit, të cilit nuk kemi mundur t'ia shpërblejmë! Shpërblimin e tij ia kam lënë Allahut të lartësuar. Të gjitha dyert e xhamisë mund të mbyllen, përveç derës së Ebu Bekrit, ajo nuk do të mbyllet kurrë!"

Përpara se të zbriste nga minberi, Pejgamberi (a.s) iu lut Allahut xh.sh për myslimanët. Ndër të tjera, ai tha: "Allahu ju ruajtë, Allahu ju bëftë strehë, Allahu ju ndihmoftë, Allahu ju forcoftë, Allahu ju dhëntë mbështetje..."

Përpara se të zbriste nga minberi, ai tha: "O njerëz, jepuni selam të gjithë atyre që do më ndjekin nga ymeti im deri në ditën e Kijametit".

Edhe një herë e mbartën të Dërguarin e Allahut deri në dhomën e tij. Teksa i ndodhej në atë gjendje, hyri për ta parë Abdurrahman ibn Ebu Bekr, i cili mbante në dorë një misvak. Pejgamberi (a.s) ia nguli sytë misvakut, por nga gjendja e rëndë që kishte nuk mund të fliste dhe ta kërkonte. Aishja (r.a) e kuptoi dëshirën e tij dhe mori misvakun nga dora e vëllait të tij Abdurrahmanit dhe ia vendosi në gojë të Pejgamberit (a.s). Por, i Dërguari i Allahut nuk ishte në gjendje ta përdorte, prandaj Aisheja (r.a) e zbuti vetë misvakun dhe ia pastroi gojën Pejgamberit (a.s).

Pastaj hyri Fatimja (r.a) bija e Pejgamberi (a.s). Sapo hyri në dhomë ajo qau, sepse i Dërguari i Allahut (a.s) nuk u çua në këmbë për ta pritur dhe për ta përqafuar siç e kishte zakon ta priste vajzën e tij sa herë që ajo vinte. Pejgamberi (a.s) i tha: "Afrohu tek unë o Fatime". I foli lehtë në vesh dhe ajo qau edhe më shumë. E thirri përsëri: "Afrohu tek unë o Fatime". I foli përsëri në vesh dhe ajo qeshi. Aisheja (r.a) tregon se pasi që Profeti (a.s) ndërroi jetë, e pyeta Fatimen se çfarë të tha i Dërguari (a.s)? Ajo tha: "Herën e parë më tha: "O Fatime, sonte do të ndërroj jetë", kështu që qava. Por, kur më pa duke qarë tha: "O Fatime, ti do jesh e para prej familje sime, që do të më pasosh në jetën tjetër" *(do jesh e para prej familjes që do vdesësh pas meje),* prandaj dhe qesha".

Pastaj, Pejgamberi (a.s) tha: "Nxirrini nga dhoma njerëzit" dhe më tha: "Afrohu tek unë o Aishe". U mbështet tek unë, ngriti dorën lart dhe tha: "Në shoqëri të Lartmadhërishmit, në shoqëri të Lartmadhërishmit!". E kuptova se atij po i kërkohej të zgjidhte. Dora iu lëshua dhe koka iu rëndua. E kuptova se tashmë ai (a.s) ndërroi jetë. Nuk e dija se çfarë të bëja. Nuk pata zgjidhje tjetër, vetëm se dola nga dhoma dhe hapa derën që të çonte në xhami nga ku shiheshin njerëzit. U thashë: "I Dërguari i Allahut ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut ndërroi jetë". E gjithë xhamia u mbush me të qara. Ali ibn Ebi Talib (r.a) ra në vend, Uthman ib Affan (r.a) filloi të bënte si fëmijë, Umer ibnul Hatabi (r.a) ngriti shpatën lart dhe tha: "Kush thotë se i Dërguari i Allahut ka vdekur, kam për t'ia këputur kokën. Ai ka shkuar për të takuar Zotin e tij, siç shkoi Musai (a.s) për të takuar Zotin e ti dhe, ai do të kthehet e do të vrasë këdo që ka thënë se ai ka vdekur". Ndërsa, njeriu më i përmbajtur ishte Ebu Bekri (r.a). Ai hyri në dhomën ky gjendej trupi i Pejgamberit (a.s), e përqafoi atë dhe tha: "O mik i shtrenjtë, o i dashur, o i Dërguar". E puthi Pejgamberin (a.s) dhe tha: "I mirë ishe i gjallë dhe i mirë qenke i vdekur, o i Dërguar i Allahut". Pastaj doli nga dhoma dhe iu drejtua njerëzve: "Kush e ka adhuruar Muhammedin, le ta dijë se Muhammedi ka vdekur. Dhe, kush e ka adhuruar Allahun, le ta dijë se Allahu është i gjallë dhe nuk vdes kurrë!". Shpata ra nga dora e Umerit (r.a) dhe ai tha: "E kuptova se ai ka vdekur". Umeri (r.a) tregon: "Dola jashtë dhe nisa të kërkoja ndonjë vend për t'u ulur dhe nisa të qaja i vetëm".

Pejgamberi (a.s) po varrosej dhe Fatimja (r.a) thoshte: "Si ju bën shpirti dhe dora të hidhni dhe mbi fytyrën e të Dërguarit të Allahut?!".

Manifestimi i mevludit:
Domosdoshmëri kohe, jo risi e dëmshme

Nexhat Ibrahimi

Në një kohë të gjatë vazhdon të trazohet pluhuri rreth Mevludit, bën apo nuk bën, është risi apo nuk është risi, bëhet mëkat me këndimin e tij apo nuk bëhet etj. etj.. kjo çështje nxitet dhe sforcohet sidomos nga jomedhhebistët.

Shkrimi është i shkurtër dhe nuk mund t'i trajtojë të gjitha këto pikëpamje, por do të përpiqet të fokusojë disa aspekte që duken më të rëndësishme.

Temë qendrore e tërë këtij diskutimi është nocioni i risisë, bid'atit, i cili diskutohet pa nevojë, dhe po pa nevojë humbet energji në sharjet e ndërsjella. Pa nevojë është diskutimi në aspektin që ndodh shumë herë ndër ne, kurse nuk është pa nevojë vetë mevludi dhe diskutimi për të. Është respektivisht i panevojshëm konteksti i diskutimit, por jo vetë tema, sepse në thelb nuk ka tema të gabuara, tabu-tema, por ka akcese të gabuara dhe metodologji të gabuara.

Gjuhësisht *bid'at* është çështje e futur, e prodhuar rishtazi. Termonologjikisht, bid'at është ajo që është futur në fe pasi që feja është mbyllur, pasi që është plotësuar; bid'at është ajo që nuk e ligjëson shkronja e Kur'anit e as e përcakton Pejgamberi a.s.; bid'at është risi apo devijim nga praktika e zakonshme fetare ose jetësore islame. Nisma e këtij diskutimi zë fill sidomos në perceptimin e hadithit të Muhammedit a.s.:

Men ahdethe fi emrina hadha ma lejse minhu fe huvve redd

"Ai që fut në çështjen (fenë) tonë diç që nuk është nga ajo, kjo do të refuzohet (nga ana e Allahut)."

Kul-lu muhdethetin bid'atun ...

"Çdo risi është bid'at ...".

Perceptimi dhe pastaj komentimi i ngurtë i këtyre haditheve ka ngritur pluhurin dhe ka ngritur barriera drejt të kuptuarit të rrugës së drejtë. Metodologjia e komentimit të hadithi është nxjerrë nga konteksti dhe ka shkaktuar gjithë këtë rrëmujë e përçarje të paparë. Këtë problem e patën parasysh edhe as'habët, ndaj edhe reagimi i tyre ishte i matur. Ja disa shembuj:

1. Ezani i dytë

Gjatë kohës së Omerit r.a. futet falja e namazit të teravisë me xhemat prej 20 rekatesh. Gjatë kohës së Muhammedit a.s. namazi i teravisë falej individualisht… Omeri r.a. për këtë risi tha:

Ni'metil-bid'atu hadhihi"

"Sa i bukur është ky bid'at"!

Analiza e këtij pohimi tregon se Omeri r.a. i vlerësoi të mirat dhe të këqijat (eventuale) të këtij tubimi të muslimanëve dhe konstatoi se kjo praktikë e cila nuk ishte e pranishme në kohë të Muhammedit a.s. shkon në dobi të muslimanëve. Edhe pse ishte e qartë se ky veprim ishte bid'at (risi), asnjë nga as'habët nuk e kundërshtoi këtë praktikë.

2. Ndarja e presë së luftës

Gjatë kohës së Omerit r.a. kufijtë e shtetit musliman u shtrinë në shumë drejtime. U pushtua Siria, Iraku dhe vende të tjera. Deri atëherë ishte zakon që preja e luftës të shpërndahet ndër luftëtarët dhe kjo argumentohej me ajetin 41 te sures El-Enfal. Kështu është vepruar edhe me prenë e luftës pas pushtimit të Hajberit, në kohën e Muhammedit a.s.. Omeri r.a. e analizoi territorin e ri, i cili ishte bujqësor dhe Arabinë i cili ishte vend jobujqësor, ngaqë banorët e saj merreshin me tregti e luftëra, por jo me bujqësi. Ndarja e tokës ndër luftëtarët pa prirje dhe send për bujqësi do ta dëmtonte bujqësinë dhe kultivimin e kulturave bujqësore dhe do të bënte që luftëtarët ta tregtojnë tokën bujqësore dhe nga kjo tregti do të kenë dobi vetëm individët. Për këtë arsye, ai vendosi që tokën t'ua linte pronarëve dhe në këtë vendim e përkrahën Osmani r.a., Aliu r.a., Talhaja r.a. dhe Ibn Omeri r.a.

3. Ezani i dytë në namazin e xhumasë

Deri para sundimit të Osmanit r.a. ishte zakon që para namazit të xhumasë të këndohej një ezan. Por, Osmani r.a. e futi leximin edhe të ezanit të dytë. Kjo traditë mbeti deri në ditët tona dhe nuk pati kundërshtime nga njerëzit eminentë të kohës së tij apo më vonë, pos individëve.

Mund të konkludohet se as'habët, tabiinët dhe shumica e dijetarëve me famë gjatë historisë islami kanë kuptuar hadithet mbi qortimin e bid'atit ashtu që bid'at të papranuar kanë quajtur ata bid'ate që kundërshtoheshin me bazat e sheriatit, siç është bid'ati i mohimit të kaderit të Zotit, shpallja për mosbesimtar të personit që bën mëkat të madh etj.

Në këtë aspekt do të duhej të kuptohej edhe shënimi i mevludit, regaibit, mi'raxhit, kadrit, dhiari në fund të namazit, duaja pas namazit etj.

Këtë mendim tonin e vërteton edhe hadithi vijues:

Men senne fil islami sunne hasene fe lehu exhruha...

"Kush vendosë në Islam një traditë të mirë (sunnet), do të ketë shpërblim për të, madje edhe shpërblimet e atyre që do ta praktikojnë pas tij pa ua munguar asgjë në shpërblimet e atyre, ndërsa kush vendos në Islam ndonjë traditë të keqe, do të bartë për këtë barrën e të keqes së të gjithë atyre të cilët do ta praktikojnë pas tij, pa u munguar asgjë në barrët e tyre."

Kjo tregon se bid'ati ndahej në bid'at të mirë, të lavdëruar (hasen) dhe bid'at të keq (sejjieh).

* * *

Konkretisht, këndimin e Mevludit i pari e futi El-Muzaffer Ebu Se'id Kevkeberi në fillim të shekullit të shtatë hixhrij. Kjo metodë e manifestimit të dashurisë ndaj Muhammedit a.s. dhe e ringjalljes së sirës (jetëshkrim) së tij shumë shpejt u bë e dashur në tërë botën myslimane. Kjo metodë u shtri jo vetëm me rastin e ditëlindjes së Muhammedit a.s., por edhe në rastet e dasmave, lindjes së fëmijëve, shkuarje-ardhjes nga haxhi, ndejeve pasmortore, ndërtimit të shtëpisë së re etj. etj.

Këtë praktikë të re e përshëndeti një numër i madh dijetarësh, si Askalaniu, Sujutiu etj.

Prandaj, bid'at, risi në kuptimin e mirëfilltë, quhet çdo risi që kundërshton frymën e Islamit e jo vetëm në lidhje më faktin nëse ka qenë apo jo një veprim i caktuar në kohën e Muhammedit a.s. Kjo tregon se manifestimi i mevludit nuk është risi (bid'at) i qortuar, por domosdoshmëri kohe, metodë jashtëzakonisht e përshtatshme për prezantimin e mësimeve islame, e sidomos për prezantimin e jetës dhe veprës së Muhammedit a.s. ndër ato shtresa të popullsisë që për formë të mësimit kanë zgjedhë formën e mevludit (Leximin e Kur'anit, recitimin e ca fragmenteve nga ndonjë tekst mevludi, këndimin e ndonjë ilahije e kasideje, pyetje-përgjigjeve dhe përmbajtjeve të tjera që mund të bëhet sipas aftësisë së imamit dhe kërkesave të xhematit). Kjo formë është tradicionale dhe depërton atje ku e ka vështirë të depërtojë punëtori fetar në raste të tjera. Personalisht, nuk kam asnjë dilemë nëse duhet të organizohet mevludi, por dilemën e kam si ta bëjmë organizimin e mevludit sa më efikas, sa më të drejtpërdrejtë, sa më të frytshëm. E gjithë forca duhet të jepet në këtë rrafsh: si të organizohet një mevlud me përmbajtje më cilësore.

Roli dhe karakteri i profetit të bekuar

Sejjid Husein Nasr

Në mjaft vargje të Kur'anit Fisnik, si XXXIV:50, XL:55 dhe XLVII:19, përmendet fakti se Profeti i Islamit ishte njerëzor e jo hyjnor në kuptimin e një mishërimi, mirëpo këto ajete nuk e mohojnë aspak madhështinë përparësore të Profetit të Bekuar, si më i përkryeri i qenieve njerëzore, si "xhevahiri mes gurëve" në vargun e famshëm poetik. Përndryshe, si mundet po ai Kur'an të pohojë se ai ishte zgjedhur si shembulli *(usve)* më i mirë për t'u ndjekur. Pikërisht në sajë të përsosjes së mbartur prej tij, ai u ka shërbyer si shembull i përkryer brezave të muslimanëve. Nuk ka asnjë dyshim se atij iu dha nga Zoti një shquarje e atillë, që është e pazakontë dhe jo thjesht njerëzore, siç përdoret kjo fjalë sot, ndonëse teologjikisht ai nuk ishte me prejardhje hyjnore, por njeri. Nuk ka provë më të mirë të shquarjes së tij të jashtëzakonshme, sesa pagabueshmëria e tij *('ismeh)*, pra fakti që ai ishte i mbrojtur nga Zoti prej gabimit, qoftë në kuptimin e veçantë - që vetë lënda e tij kish qenë që prej fillimit imune nga mëkati, ose që ai ishte "larë" dhe kulluar nga engjëjt - siç dëshmon ngjarja e treguar më lart për larjen e kraharorit të tij nga melekët. Gjithsesi, nuk ka rrezik më të madh për muslimanët e sotëm se ai i të reduktuarit të madhështisë së mrekullueshme të Profetit të Bekuar në terma mendjengushta njerëzore, me justifikimin e jashtëm se ai ishte thjesht njeri, por duke i shërbyer në të vërtetë [me këtë reduktim] humanizmit mbizotërues të Perëndimit modern. Fakti se Profeti i Bekuar ishte njeri, nuk do të thotë se ai ishte i zakonshëm si çdo qenie njerëzore, por që gjendja njerëzore e zotëron mundësinë e madhështisë dhe plotësisë të shpalosur nga personaliteti dhe karakteri i tij. Të përsiaturit mbi jetën, virtytet dhe arritjet e Profetit të Bekuar, do të thotë të kuptohet jo vetëm madhështia e fuqisë së Zotit dhe e profetëve të tij, por edhe fakti se njerëzimi si tërësi jeton kaq poshtë nivelit të njerëzores së vërtetë. Profetët dhe shenjtorët i shpalosin njerëzimit mundësinë totale të ekzistencës. Janë pikërisht ata, që e ngrejnë kuptimin e fjalës "njeri" në rasën e saj më të lartë dhe njeriut s'i bëhet dot dëm më i madh se sa të reduktuarit e tyre në standartet mendjengushta dhe shpesh të papërfillshme të njeriut modern; në vend që t'i mbajnë si ideale e shembuj të përhershëm, që mund t'i ndihmojnë njerëzit ta realizojnë (të paktën në njëfarë shkalle) natyrën tërësore dhe të plotë të gjendjes njerëzore.

Për breza të tërë muslimanësh, para se humanizmi i

botës moderne të ndotte mendjet dhe shpirtrat e shumë prej tyre, Profeti i Bekuar e përmbushi një mision të tillë në nivelin më të lartë dhe ai mbetet e do të mbesë, për sa kohë që Islami të jetojë si fe, shembulli i epërm për t'u ndjekur nga njerëzit. Profeti i Bekuar, në njëfarë kuptimi, e kaloi plotësisht gjithçka njerëzore për t'ia dalë në përmbushjen e këtij funksioni, ashtu siç depërtoi Islami në çdo aspekt të jetës njerëzore, që të mund ta integronte krejt jetën në Qendrën, që i shenjtëron dhe u jep kuptim të gjitha gjërave.

Nuk ekziston praktikisht asnjë aspekt i jetës njerëzore, të cilin Profeti i Islamit të mos e ketë përjetuar. Në nivelin personal dhe njerëzor, ai provoi humbjen e prindërve në moshë të njomë, vetminë, trysnitë shoqërore, varfërinë materiale dhe praktikisht çdo lloj vështirësie që mund të kalojë një i ri në shoqëri. Më vonë, ai do të dëshmonte çdo formë pikëllimi, humbjen e gruas së tij të dashur Hatixhe, vdekjen e hershme të djemve, tradhtinë e anëtarëve të fisit, kërcënime të vazhdueshme të jetës, të pronës e të familjes së tij, pa përmendur rreziqet e vazhdueshme që ndeshi kauza për të cilën ai ishte zgjedhur dhe së cilës ia kishte kushtuar tërësisht vetveten: Islami.

Ngaqë jeta njerëzore është e thurur me fije gëzimi e pikëllimi, Profeti i Islamit u bekua gjithashtu me përvojën e çdo gëzimi të mundur për qeniet njerëzore, duke filluar sigurisht me atë gëzim më të lartë, e në fakt ekstazë, që është njohja dhe dashuria e Zotit, dhuntia supreme që iu dha si bekim i veçantë nga Qielli, me një gradë ekzaltimi e intensiteti të papërfytyrueshëm për qeniet e tjera njerëzore. Por, në nivelin më të zakonshëm të jetës njerëzore, ai u bekua me gëzimin e një martese shumë të lumtur me Hatixhen, e të paturit të një bije si Fatimja, e një kushëriri dhe dhëndri si Aliu, devotshmëria e të cilit ndaj Profetit dhe përkushtimi ndaj thirrjes së tij janë të jashtëzakonshme me çfarëdolloj standartesh që të gjykohen. Profeti i Bekuar kishte po ashtu shokë e nxënës të përkushtuar si Ebu Bekrin dhe Selmanin dhe e kishte shijuar kuptimin e plotë si të miqësisë njerëzore, ashtu dhe të Hyjnores (duke qenë vetë miku i Zotit, *habib-Allah*). Ai kishte provuar aspekte të natyrës njerëzore, që nga pozita e favorshme e të qenit jetim i varfër, tregtar i suksesshëm, udhëheqësi i rrezikuar i një bashkësie gjysëm-klandestine dhe prijësi ngadhënjimtar i një shoqërie të re, e cila së shpejti do të pushtonte pjesën më të madhe të botës. Ai u kishte shitur mallra tregtarëve të vegjël, si dhe u kishte dërguar letra perandorëve e sundimtarëve më të fuqishëm mbi

dhé, duke i ftuar në kauzën e Islamit. Ai kishte shijuar si humbjen, edhe fitoren, e madje ishte bekuar me mundësinë e përjetimit të gëzimit të pakrahasueshëm të faljes së armiqve të tij më të këqinj në çastin e çlirimit të Mekës. Së fundi, ai kishte shijuar edhe dështimin edhe suksesin. Ai ngulmoi për vite të gjata me durim e mbështetje te Zoti, duke dëshmuar dështime të hidhura dhe pastaj u destinua të shijonte ëmbëlsinë e sukseseve të njëpasnjëshme, deri në shkallën sa të realizonte, para vdekjes, gjithçka që kishte synuar të arrinte. Me siguri ka pakgjë, që një musliman mund të kalojë dhe pak situata që mund të ndeshë në jetën njerëzore, pa patur një preçedent në jetën e Profetit, që mund t'i shërbejë si model dhe burim frymëzimi e udhëzimi.

Përsa u përket funksioneve themelore në shoqëri, përsëri i Dërguari i Allahut ishte destinuar nga Zoti t'i përmbushte thuajse të gjitha. Ai ishte mësues, kryefamiljar, tregtar, prijës politik e shoqëror, udhëheqës ushtarak, gjykatës dhe sundues suprem, për të mos folur për funksionet specifikisht profetike si sjellja e një Ligji Hyjnor dhe Fjalës së Zotit për njerëzimin, duke i udhëzuar njerë-

zit si në dije ezoterike, ashtu dhe ekzoterike, i dhuntisur me njohje të plotë të natyrës njerëzore dhe psikologjisë së njerëzve në çaste të ndryshme e raste të larmishme, etj.

Në secilin prej këtyre funksioneve, ai la pas një trashëgimi të vyer, e cila është bërë pjesë thelbësore e Islamit dhe e kulturës së tij. Si mësues, Profeti i Bekuar ishte jashtëzakonisht i suksesshëm në përcjelljen e diturisë së niveleve të ndryshme tek tipa shumë të ndryshëm njerëzorë. Në të vërtetë, ai ishte mësuesi i epërm. Ai ishte aq i suksesshëm si mësues, saqë ende sot mbetet mësuesi më i rëndësishëm për muslimanët. Thëniet dhe veprat e tija, mendimet dhe veprimet e tija e mësojnë akoma bashkësinë e tij ditë e natë, ndërkohë që udhëzimet më intelektuale e shpirtërore të kumtuara prej tij vazhdojnë të formësojnë dhe të mbrujnë mendjet e shpirtrat e atyre anëtarëve të bashkësisë Islame, që janë në kërkim të përsosjes shpirtërore.

Si kryetar familjeje, Profeti i Bekuar krijoi një shoqëri në miniaturë dhe në fakt një univers, struktura dhe marrëdhëniet e brendshme të të cilit u interesojnë pamasë muslimanëve të devotshëm edhe sot e kësaj dite. Mënyra e tij e sjelljes me bashkëshortet, fëmijët dhe nipat e tij të vegjël, Hasanin e Huseinin, detyrimet dhe funksionet brenda shtëpisë, ndjenja e përgjegjësisë ndaj familjes, ngulitja nga ana e tij e dashurisë dhe besimit mes anëtarëve të familjes e shumë elemente të tjera janë pjesë e Sunnetit dhe përbërës të karakterit të tij. Këto e bëjnë atë një shembull për t'u ndjekur e emuluar jo vetëm si individ, por edhe në kontekstin e familjes njerëzore. Po ashtu, mënyra në të cilën ai sillej kur ishte tregtar, kur gjykonte një rast, ose vepronte si prijës ushtarak në mejdan, apo sundonte një bashkësi njerëzore a vendoste mbi një problem diplomatik, zbulojnë secila aspekte të një qenieje që ishte zgjedhur për të përmbushur tërë mundësitë e ndodhura në natyrën njerëzore. Është kthjelluese të mbahet mend se i njëjti person që udhëhoqi betejën e Bedrit dhe i cili më vonë sundoi një segment të tërë të universit, përgjunjej në dyshemenë e shtëpisë së tij modeste, që nipat t'i hypnin shpinës e ta ngisnin nëpër dhomë. Vetëm një pejgamber mund të arrijë një përsosje të tillë madhështie e përulësie, fuqie dhe bujarie, por fakti se mund ta arrinte këtë tregon se sa i madh mund të jetë njeriu, sikur vetëm ta dinte se kush është.

Sigurisht, çdo profet dhe sidomos i fundit prej tyre i zotëron të gjitha virtytet njerëzore, por në rastin e secilit profet veçohen dhe theksohen një sërë virtytesh, që lidhen me strukturën e fesë së sjellë në këtë botë prej tij. Virtyti i dallueshëm i disa profetëve ka qenë dashuria dhe i disave tërheqja, frika e Zotit e asketizmi. Sa i përket Pejgamberit, virtytet e tij dalluese ishin sinqeriteti ndaj Zotit e të Vërtetës, bujaria ndaj të gjitha qenieve dhe varfëria e përshpirtshme e shoqëruar me thjeshtësi dhe përulësi. Profeti i Bekuar ka thënë: "Varfëria është krenaria ime" (*el-fekr" fakhri*) dhe spiritualiteti islam quhet shpesh "varfëria muhammedane" (*el-fekr el-muhammedi*). Kjo nuk nënkupton se Pejgamberi ishte kundër njerëzve të pasur apo se i përbuzte të mirat e kësaj bote. Fundja, vetë bashkëshortja e tij Hatixhja ishte tregtare e pasur. Ajo çfarë ky *fekr* donte të thoshte, ishte në thelb përulësia dhe vetëdija për hiçin tonë para Zotit, duke parapëlqyer thjeshtësinë ndaj zbukurimeve e luksit. Profeti i Bekuar ishte i rreptë ndaj vetes dhe kërkonte vazhdimisht ta disiplinonte veten. Ai gjithmonë e theksonte përulësinë, ndonëse ishte më i madhi i njerëzve dhe pa dyshim i ndërgjegjshëm për natyrën e tij. Por shumë nga Sunneti dhe *edebi*, ose mënyra e sjelljes së tij, ekziston me qëllimin e rrënjosjes së virtytit të përulësisë (*teuadu'* apo *hushu'*), forma më e lartë e të cilit është vetëdija jonë e të qenit asgjë përpara Zotit, e simbolizuar edhe nga sexhdet gjatë namazit të përditshëm.

Profeti i Bekuar ishte gjithashtu plot bujari e zemërgjerësi (*keramet* ose *sheref*). Po aq sa ç'ishte i rreptë me veten, ai ishte bujar me të tjerët. Fisnikëria e karakterit do të thotë edhe të japësh edhe të marrësh, dhënien e vetes dhe përpjekjeve, mendimeve e zotërimeve tuaja të tjerëve e faljen e gabimeve të tyre dhe asaj që të kanë bërë. Jeta e Profetit të Bekuar ishte plot me raste, në të cilat ai u dha të tjerëve e ishte bujar në kuptimin më të plotë të termit, si dhe me çaste faljeje, ndër të cilat pushtimi i Mekës është shembulli i epërm. Këtu u shpalos fisnikëria e karakterit në majën e saj, sepse ai ua fali, duke qenë në kulmin e fuqisë, atyre që i kishin bërë padrejtësi në mënyrën më të keqe përgjatë viteve. Gjatë disa çasteve kur vepronte si gjykatës dhe nuk i falte shkeljet e dikujt, ai kishte ndërmend drejtësinë e Zotit dhe mirëqenien e bashkësisë. Ai nuk veproi si individ, por si funksionues i një kolektiviteti njerëzor. Përndryshe, nuk pati kurrë ndonjë ndjenjë hakmarrjeje personale ose shpagimi në veprimet dhe trajtimin e të tjerëve prej tij.

Së fundi, Profeti i Bekuar zotëronte virtytin e sinqeritetit *(ihlas)* në plotësinë e vet. Nuk ka veprim që ai kreu ose fjalë që shqiptoi pa sinqeritet të plotë. Por mbi të gjitha, ai që i sinqertë me Zotin dhe sinqeriteti i tij ishte i njëjtë si besnikëria *(sidk)* e tij. Fakti se ai u quajt el-Emin (i besuari) qysh në rini do të thotë se kjo cilësi ishte e pranishme në mënyrë të dallueshme tek ai që nga fëmijëria e ishte përsosur kur ai u zgjodh si i Dërguar i Zotit. Jo vetëm që Profeti nuk gënjente kurrë, por si rezultat i këtij virtyti të sinqeritetit dhe të besnikërisë, ai mundi ta vendoste gjithçka në vendin e vet, të ishte i logjikshëm dhe objektiv në gjykimin e ngjarjeve, ideve e personave dhe të shmangte shtrembërimet subjektive e individualiste. Por mbi të gjitha, kjo donte të thoshte se ai ishte i prirur të shihte të vërtetën e ta merrte atë pa ia ndryshuar natyrën dhe përmbajtjen. Ja përse ai u bekua me dijen e më të thellës të së vërtetave, që është *La ilahe il-la'Llah* dhe u zgjodh për ta përhapur këtë të vërtetë qendrore dhe thelbësore mbi faqen e dheut.

Karakteri i Pejgamberit të Bekuar, i stolisur me virtytet e sinqeritetit, bujarisë dhe përulësisë ose besnikërisë, fisnikërisë dhe thjeshtësisë, u spërkat po ashtu edhe nga parfumi i butësisë dhe gufimi i lumturisë, me të cilat ai kujtohet edhe sot anekënd botës islame. Kur termi "karakter muhammedan" *(el-khulk el-muhammedi* në arabisht dhe *khuj-i mohammedi* në persisht e urdisht) përdoret në disa gjuhë islame, ai nënkupton gjithmonë këtë ndjesi butësie dhe gëzimi të shoqëruar me thjeshtësinë, fisnikërinë dhe besnikërinë e përmendur më lart. Kur pohohet se filani ka *khu* ose *khulk-i muhammedi*, do të thotë se ai është i bekuar me këto virtyte, se nuk zemërohet pa shkak, se është i qetë dhe i përmbajtur, se ka durim e mirësi ndaj të tjerëve, se rri në gjendje gëzimi e lumturie dhe nuk jepet pas agjitimit e ankimit të vazhdueshëm. Muslimanët nuk dështojnë të kujtojnë se Profeti i Bekuar qeshte gjithmonë dhe kishte një ndjesi lumturie e gëzimi, që i buronte nga fytyra, sigurisht pa përjashtuar "zemërimin e shenjtë", kur ndeshte kundërshtuesit e së Vërtetës. Por gjëja e mahnitshme është se në shpirtin e tij ekzistonte si fuqia, ashtu edhe butësia, si ashpërsia dhe pastërtia e shkretëtirës, ashtu dhe puhiza e parfumi i trëndafilishtes. Ai e shndërroi botën dhe kreu detyrat më të jashtëzakonshme, nën vështirësi të pabesueshme, por gjithnjë me mirësinë e bujarinë që i karakterizon të dashurit e Zotit *(eulija')*. Në të ishin bashkuar përsosjet më të larta. Ai ishte me të vërtetë njeriu i përkryer, para të cilit engjëjt u urdhëruan të përuleshin. Ja përse Zoti dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë dhe e bekojnë atë, dhe besimtarët urdhërohen që edhe ata ta lavdërojnë dhe ta bekojnë, duke i modeluar jetët e tyre sipas tij. Ç'është e vërteta, lavdërimi i Profetit është akti i vetëm që njeriu e ndan me Zotin dhe me engjëjt.

Feja e fundit Pejgamberi i fundit

Asuman Dogru

Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) është profeti i fundit dërguar njerëzimit. Ky fakt bën që sistemi që ka sjellë të jetë:

1-Sistem i mrekullueshëm
2-I paprishur dhe i pacënueshëm
3-Të jetë i vetëm dhe paalternativë
4-Të jetë universal

Nisur nga kjo, me të vërtetë Islami i përmbledh në vetvete të gjitha këto tipare.

Islami është i mrekullueshëm

Islami ruan në brendësinë e tij tipare të tilla si "tërësi" dhe "ekuilibër", që përbëjnë një kusht për realizimin e së mrekullueshmes.

Islami e studion njeriun si në aspektin individual ashtu edhe në atë shoqëror, si nga ana shpirtërore ashtu edhe nga ajo fizike, pra në një tërësi të plotë. Brenda vetes e studion me gjithë shpirtin, etikën dhe mëndjen e tij, me gjithë fizikun dhe ç'ka përreth. Për çdo çështje, atij i paraqet zgjidhjen më të

mrekullueshme. Fakti që shkenca është një mbështetëse e vazhdueshme e Kuranit, përbën një tregues të rëndësishëm të kësaj mrekullie. Për shembull, Kurani ka thënë "Dy vjet qumështi i nënës" Asokohe shkenca e quante të pavlerë qumështin e nënës dhe me zhvillimet e reja mbërriti në thënien e Kuranit, duke pranuar domosdoshmërinë e qumështit të nënës për dy vjet.

Islami nuk është cënuar dhe prishur

Kjo sepse Kurani si burimi i Islamit nuk është prishur. Këtë mund ta kuptojmë më së miri duke e krahasuar atë me librat e tjerë të shenjtë. Fakti që njerëzit e kulturuar në katër anët e botës i janë drejtuar Islamit, megjithëse nuk është bërë asnjë propaganda, buron nga mrekullia e Islamit dhe e Kuranit si libër-burim i tij. Kjo gjë e mrekullueshme është një fakt i mosprishjes së tij.

Islami është i paalternativë

Kudo në botë ekzistojnë besime, ideologji, ide dhe fraksione të ndryshme. Këto, herë pas here gjejnë zbatim në shoqëri të ndryshme. Por asnjëra nga këto nuk e ka studiuar njeriun në tërësinë e vet dhe nuk ka prodhuar zgjidhje që përbëjnë një tërësi të mrekullueshme në përputhje me mendjen, shpirtin dhe shkencën, që mund t'i japë përgjigje çdo pyetjeje të tij. Prandaj, deri më tani asnjë sistem në asnjë pike, qoftë në aspektin ndjesor, qoftë në sjellje, qoftë në aspektin ekonomik apo në atë social, nuk ka arritur të krijojë një alternativë për Islamin.

Islami është universal

Islami është universal, pasi është i mrekullueshëm. Kjo sepse nuk ka alternativë. Sepse është i paprishur, i pacënuar.

Islami është universal, duke qenë se është feja e vetme e drejtë që ka mbërritur në fazën kulminante të mrekullisë. Është feja e të gjithë njerëzve dhe e gjitha kohërave. Sistemi i sjellë nuk është sistemi i një populli apo i kohe të caktuar, po përkundrazi është sistemi i Zotit që e ka bërë njeriun të qenësishëm nga asgjëja. Është sistemi në të cilin thotë – e plotësova, e bëra të mrekullueshëm dhe e pëlqeva. Kjo ka mundësuar që të jetë mbi kohën dhe hapësirën. Pra e ka bërë atë shpresë të vetme në çdo epokë për gjithë njerëzimin.

Po… Islami është feja e fundit. Është feja e fundit, pasi është më e mrekullueshmja, e paalternativë,



universale, e pacënuar, e palejueshme për të prishur dhe e mbrojtur nga Allahu.

Ose, duke qenë e fundit është bërë më e mrekullueshme, e paalternativë dhe universale, duke u marrë në mbrojtje nga Allahu i Lartmadhëruar.

Pejgamberi është profeti i fundit.

Pejgamberi i fundit…

Të qenët "i fundit" kërkon të jesh "më i madhi", më superiori", "më i mrekullueshmi"

Të qenët "i fundit" kërkon të jesh mëshirë e botëve.

Të qenët "i fundit" kërkon të kesh një mrekulli gjithpërfshirëse për gjitha kohërat, ose një mrekulli që zgjat deri në ditën e gjykimit.

Ai, për të qenë "profeti i fundit" duhet të ketë një mrekulli të tillë që të dëshmojë për gjithë njerëzimin se është Pejgamberi i fundit dhe i vërtetë dhe se sistemi që ka sjellë nuk ka alternativë, t'u tërheqë vëmendje njerëzve se nuk kanë shans tjetër dhe se

është profeti i fundit i mëshirës për njerëzimin. Kjo ka ndodhur me Kuranin. Qenia e tij si pejgamber i fundit e ka bërë Kuranin "Mrekullinë më të madhe" Ajo që ka bërë shkenca me studimet e saj në mënyrë të pavetëdijshme, ka qenë vërtetimi i mrekullisë së Kuranit.

Mrekullitë janë për të vërtetuar "të vërtetën" e Pejgamberëve

Duke qenë se Kurani është mrekullia e pejgamberit, këtë do ta dëshmojë deri në ditën e gjykimit. Kjo nxjerr në pah se këtë detyrë e ka vënë në jetë deri në ditën e gjykimit, në sajë të Kuranit, sado që i dërguari i Allahut të jetë ndarë nga kjo botë. Prandaj, çdokush që gjykon arrin të kuptojë se nuk ka nevojë për ndonjë pejgamber tjetër.

Sikur Muhamedi (a.s) të mos ishte profeti i fundit në bazë të ligjeve hyjnore, ai që do vinte pas tij do ishte i detyruar të na njoftonte emrin, veçoritë shenjat e tij. Allahu i Lartmadhëruar ka njoftuar Muhamedin (a.s) si profetin e fundit që nga Ademi (a.s e deri në fund. Çdo profet ka njoftuar njerëzit për profetin që do vinte pas tij. Kjo është bërë bazuar në mëshirën hyjnore. Zoti i botëve dëshiron që kur të vijë i dërguari i Tij, shoqëria ta presë si të tillë. Kjo gjë thuhet edhe për profetin e fundit, duke qenë se fakti që ai është i fundit përbën një rëndësi akoma edhe më të madhe për mbarë njerëzimin. Në kohën kur lindi profeti, Jahuditë dhe të Krishterët e njihnin dhe e prisnin atë si "Profeti më i madh".

Fakti që vetë Kurani është marrë në mbrojtje dhe mbikqyrje nga Allahu i Lartmadhëruar, tregon se Kurani është libri i fundit dhe se vetë profeti është pejgamberi i fundit. Krijuesi i gjithësisë nuk pati marrë në mbrojtje Tevratin dhe Ungjillin të cilët i dërgoi në fillim, Ai ia lë këtë detyrë atyre që besonin në ta; i pati paralajmëruar që mos ta prishnin atë libër të shenjtë, duke i njoftuar se nëse do ta ndryshonin do të përballeshin me fatkeqësi të shumta. Kurse në Kuran nuk kishte asnjë paralajmërim dhe asnjë kërcënim lidhur me mosprekjen e Tij. Tregohej vetëm rasti se si Jahuditë, në mënyrë të veçantë, kishin ndryshuar dhe më pas shitur apo fshehur ajetet e Allahut përkundrejt një page shumë të vogël.

Më pas, për Kuranin thuhej: "Atë ne e zbritëm dhe ne do e mbrojmë" (Hixhe, 9), "Askush nuk i ndryshon fjalët e Allahut" (En'am, 115)

Sikur të bëhej fjalë të na dërgohej një libër më i mrekullueshëm se Kurani në kohët e mëtejshme, atëherë edhe Kurani, sikurse Tevrati dhe Ungjilli, nuk mbrohej nga ana e Allahut, do mbetej i lirë për t'u ndryshuar. Kjo do të thotë se një nga urtësitë e mosmarrjes nën kontroll nga ana e Allahut të librave të tjerë dhe lënies së lirë për t'u ndryshuar, ka qenë edhe krijimi i një mundësie për njerëzit për të bërë një krahasim dhe për të nxjerrë më në pah madhështinë që ka ky libër i shenjtë.

Krijuesi i gjithësisë dëshiroi t'i jepte gjithë njerëzimit mesazhin e Drejtësisë deri në ditën e gjykimit dhe t'u tregonte atyre rrugën e drejtë dhe ndërkohë që lejoi prekjen e librave të tjerë, Kuranin e mori në mbrojtje. Kjo sepse ai ishte libri i fundit i dhënë pejgamberit të fundit, si shpresa e fundit e gjithë njerëzimit. Ishte shpresa e fundit që u paraqiste gjitha kohërave mrekullinë më të madhe.

Fakti që Muhamedi ishte pejgamberi I fundit kishte bërë të domosdoshëm dërgimin e tij për mbarë njerëzimin.

Allahu thotë në Kuran: "Kurani është një fjalë që shpjegon të drejtën për gjithë njerëzimin" (Al-I Imran, 138), "Fjalët e Zotit, pra Kurani është I plotë me të drejtën dhe drejtësinë." (En'am 115) "Padyshim që ai Kuran është një udhërrëfyes për botët, një fjalë e drejtë"

"Kurani u dërgua për të paralajmëruar nënën e qyteteve dhe qytetet e tjera përreth" (En'am, 92) me të cilin theksohet se është dërguar për gjithë njerëzimin. Ndërsa për pejgamberin thuhet: Është një mëshirë për botët" duke u theksuar kështu se është dërguar si profet I fundit me librin e fundit për gjithë njerëzimin.

Shkenca në islam

Ma. Artur Tagani

Ndryshe nga fetë e tjera, feja Islame dallohet për rëndësinë që i kushton diturisë. Në historinë Islame nuk gjenden shkencëtarë që të jenë dënuar, torturuar apo vrarë për arsye të tezave të tyre shkencore. Pëkundrazi, shtetet Islame ndër shekuj kanë kontribouar për dije, kanë ndarë buxhet për shkencën dhe kanë ndërtuar institucione të rëndësishme kërkimore.

Besimi Islam nuk është se thjeshtë stimulon diturinë, por diturinë e ka bërë obligim për secilin njeri, pa dallim gjinie a moshe. Feja Islame nuk bën dallim nga aspekti burimor i diturisë ose me fjalë të tjera ajo nxit të arrihet dituria edhe nëse gjendet tek jomyslimanët. Feja Islame vë në dukje rëndësinë që i kushton diturisë edhe në rastin kur e konsideron adhurim, çdo përpjekje që bën një shkencëtar apo studiues në rrugën e diturisë apo të shkencës.

Myslimanët që nga shekulli VII filluan të zgjerojnë kufijtë dhe të hasen me kultura të ndryshme. Me fuqinë e bindjes dhe me shpirtin dinamik që kishte ushqyer Islami tek myslimanët, si dhe me horizontin e gjerë që kishin formuar, ata nuk qëndruan vetëm brenda kufijve të botës islame në fushën e diturisë, shkencës dhe mendimit, por kryesisht në shekujt XI dhe XII ndikuan në mënyrë të theksuar në Mesjetën Evropiane. Ndërtimi i medreseve "Nidhamije" në Lindje, ashtu siç ndikoi në përhapjen sistematike të shkencës dhe mendimit në botën Islame, po ashtu bëri të mundur që në Perëndim të pezullonte botëkuptimin e diturisë dhe shkencës së kufizuar që ndodhej nën kontrollin e manastireve lokale. Madje si nga aspekti i strukturës arkitektonike ashtu edhe për vite të tëra metodologjia dhe sistemi i medreseve në fjalë u bë model në formimin e universiteteve që filluan të ndërtoheshin nga shekulli X si ai i Bolognia-s, i Padua-s, i Sorbonne-it, i Montpellier-it, i Oxford-it, i Köln-it, etj.

Shkenca Islame, që nga shekulli IX ka treguar një zhvillim të shpejtë si në shkencat pozitive; matematikë, astronomi, fizikë, mekanikë, mjekësi, kimi dhe farmaci, ashtu edhe në shkencat sociale dhe në fushën e filozofisë. Veçanërisht në metodën shkencore ata kanë hedhur hapa gjigandë. Pasuria e shkencës Islame e formuar nga shkencëtarët dhe mendimtarët myslimanë duke i zgjeruar dhe zhvilluar me më metodë mendimet e filozofëve antikë, duke plotësuar hapësirat dhe duke korrigjuar gabimet e tyre, ashtu sikur bëri të mundur të diskutohet dhe të shkatërrohet Skolastika Mesjetare, në të njëjtën mënyrë deri në një farë pike ka përgatitur bazat e formimit dhe të zhvillimit të Renesancës dhe të shkencës së Epokës së Re.

Kontributi i dijetarëve myslimanë në fushën e shkencës u shfaq pas analizave dhe hulumtimeve serioze që i bënë diturive të mëparshme. Matematika e përdorur në kulturën indiane, iu ofrua njerëzimit pasi u studiua dhe iu dha një sistem nga matematikanët myslimanë. Si rrjedhojë e kësaj pune, tashmë matematika gëzon një gjuhë universale.

Nuk mund të mohohet pjesa e rëndësishme e kontributit të dijetarëve myslimanë shekuj më parë në formimin e sistematikës së metodës empirike e cila startoi nga shekulli XVII. Madje në shekullin XIV Roger Bacon-i në veprat e tij ka nënvizuar rëndësinë e mendimeve të Ibni Sinasë dhe Ibni Hajthemit lidhur me kontributin e tyre në këtë fushë.

Mirëpo ndërkohë që në Perëndim në shekujt XVI dhe XVII vijonin zhvillime në fushën e shkencës dhe teknologjisë, në botën Islame fillimisht u paraqit vendqëndrimi dhe më pas prapambetja nga aspekti i shkencës.

Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

"Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!" (Al-i Imran, 3/31)

Ky ajet zbriti atëherë kur jahudijtë u shprehën "Ne jemi djemtë dhe të dashurit e Allahut", kur të krishterët thanë "Ne e adhurojmë Isain nga dashuria që kemi për Allahun" dhe kur mushrikët thanë "Ne adhurojmë idhujt për hatër të dashurisë që kemi për Zotin si dhe për hatër të besimit që kemi se ato do të na afrojnë kah Ai". Allahu i Lartmadhëruar i urdhëroi që t'u bindeshin Resulullahut, nëse janë të sinqertë në fjalët e tyre. T'i bindesh Resulullahut do të thotë të zbatosh ato që ai urdhëron, të largohesh nga ato gjëra që ai t'i ndalon dhe ta marrësh atë si shembull në çdo çështje. E kundërta e kësaj, që unë e dua Allahun, por nuk ia vë veshin urdhëresave të Tij, që nuk i dua ata që Ai do dhe ata që e duan, pra të dërguarit e Tij, kjo do të thotë se nuk dëshiron t'i përngjasosh atyre dhe se nuk do askënd tjetër përveç vetes, e si përfundim do të thotë se nuk dëshiron të ecësh në rrugën e tevhidit.

Kur u shpall ky ajet, hipokriti Abdullah ibni Ubej tha:

"Muhamedi po pretendon se bindja dhe adhurimi ndaj tij është bindje dhe adhurim ndaj Zotit. Ai po kërkon që ta duam atë si ashtu si të krishterët Isain."

Më pas, në lidhje me këtë u shpall ky ajet:

"Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!" (Al-i Imran, 3/31)

Me këtë ajet Allahu i Lartmadhëruar na informoi neve se masa më e saktë e adhurimit dhe e bindjes ndaj Tij është i Dërguari i Tij. Sepse ata që njohin më së miri urdhëresat dhe ndalesat e Tij dhe që i zbatojnë ato më mirë, janë Pejgamberët. Ata e praktikuan pa asnjë mangësi rrugën e drejtë. Ata na e treguan në mënyrë të shkëlqyer se feja është rruga e të mesmes dhe e veprimit të matur. Pejgamberi i fundit e vizatoi rrugën e ndritur të Islamit, vlefshmëria e të cilit do të zgjasë deri në kijamet, duke e zbatuar atë në çdo sferë të jetës së tij. Ky stil jetese i përvijuar nga Resuli (a.s) në planin individual dhe në atë shoqëror , fjalët, veprimet e tij, miratimet apo kundërshtimet që ai ka shprehur ndaj veprimeve të të tjerëve, janë emërtuar me termin sunnet. Prandaj, **të ruash sunnetin dhe çdo gjë që ka ardhur me të, do të thotë të ruash islamin.**

Një Hadith

Transmetohet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se

Resulullahu, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"I gjithë ummeti im ka për të hyrë në xhennet, përveç atyre që nuk dëshirojnë"
Ai u pyet: -O i Dërguari i Allahut, po kush nuk dëshiron të hyjë në xhennet?
Më i Dashuri i Allahut u shpreh: -"Ata që do të më binden mua do të hyjnë në xhennet, kurse ata që më kundërvihen do të thotë që nuk e dëshirojnë xhennetin"

Dy fjalë komenti

Ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhennet mund të përmblidhen në dy grupe, ose mund të kuptohen në dy mënyra. Njëri grup përbëhet nga individë që nuk pranojnë ftesën e bërë nga **"ummeti davet"** (ummeti thirrës), pra refuzojnë ftesën që iu është bërë për të hyrë në islam dhe që emërtohen kafir. Kurse grupi i dytë, që emërtohet **"ummeti ixhabet"**, përbëhet nga individë që e kanë pranuar islamin. Këta janë njerëzit që duhet të jenë shembull në shoqëri. Në mesin e këtyre të fundit gjenden edhe ato që nuk kanë jetuar në përshtatje me mesazhin e Profetit dhe që nuk i kanë kryer obligimet fetare, dhe këta emërtohen si rebelë ose gjynahqarë.

Kafirët nuk do të hyjnë në xhennet. Kurse rebelët, pasi të vuajnë dënimin e gjynaheve të tyre në xhehennem, do të hyjnë në xhennet, ku do të qëndrojnë përjetësisht. Kjo do të thotë se gjynahi nuk ta zhduk imanin, por mundet ta shpierë njeriun në xhehennem. Por qëndrimi i këtyre të fundit në xhehennem nuk do të jetë i përhershëm si ai i kafirëve.

Sahabët u çuditën dhe deshën të mësonin nga Resulullahi se kush ishin ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhennet. Resulullahu, sallallahu alejhi ve sellem, u dha atyre një përgjigje të shkurtër, por shumë kuptimplote. Sipas përgjigjes së tij, ai që do t'i bindet Hazreti Pejgamberit do të hyjë në xhennet, kurse ai që s'do të shprehë bindje ndaj Tij, do të hyjë në xhehennem. Bindja ndaj Profetit përfshin lidhjen e fortë me Kuranin dhe Sunnetin, lidhje kjo që do ta shpjerë besimtarin në xhennet. Ndërsa kundërvënia ndaj Profetit tregon mospranim të plotë të islamit dhe atëherë ky person bie në kufër dhe hyn përgjithmon në xhehennem, ndërsa kur personi e ka besuar në mënyrë të plotë islamin por e ka neglizhuar praktikimin e tij, kjo e dërgon atë në xhehennem për të shlyer gjynahet e tij e për të hyrë mandej në xhennet.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi

1. Bindja ndaj Hazreti Resulullahut, sallallahu alejhi ve sellem, të shpije në xhennet.
2. Rebelimi ndaj Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, nëse shpreh mospranim të plotë të islamit, të shpie në xhehennem përjetësisht; nëse shpreh vetëm moszbatim të plotë të tij, atëherë kjo të shpie në xhehennem, por qëndrimi atje nuk do të jetë i përhershëm.

Osman Nuri Topbash

DASHURIA NDAJ HAZRETI PEJGAMBERIT A.S.

Mbreti Profet në sarajin e dëshmisë së njësisë.

Drita Muhamediane përbën esencën themelore të universit që u krijua me dashuri Hyjnore dhe me koncentratin e njeriut si krijesë.

Kësisoj, e vërteta Muhmediane është pasqyra që manifeston reflektimet e mbretërisë së dashurisë. Drita dashurore që është përftuar nga hija e qënies së kësaj të vërtete ka formësuar qiellin dhe tokën. Allahu i është drejtuar Atij, e kështu Ai është bërë kulm i të gjitha krijesave, një kulm i atillë, emrin e adhuruar të të cilit Allahu i Lartmadhëruar e ka përmendur qysh në ezel (parakrijim) dhe e ka shkruar në levhi Mahfudh për mos u fshirë më kurrë:

"La i lahe il-lall-llah Muham-medurr-rresulull-llah..."

Hazreti Ademit a.s., kur qe hedhur në tokë për fajin që kishte bërë në xhenet, iu pranua pendimi pasi kërkoi falje për hatër të Hazreti Muhamed Mustafasë, emrin e të cilit e kishte parë të shkruar ndër qiej. Atij iu tha:

"O Adem! Ai është më i dashuri ndër krijesat e mija. (Kur të më bësh dua) Më bëj dua për hatër të Tij! (Sepse tani për hatër të Tij) të fala. (Ta dish mirë se), po mos ishte Muhamed Mustafaja nuk do të krijoja ty." (Hakim, Mustedrek, II, 672; Bejhaki, Delail, V, 488-489)

Ashtu siç e shprehëm edhe në dëshminë e njësisë, Ai është vetëm rob (krijesë). Një rob i dorëzuar plotësisht në robninë ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Por ama këtë robni nuk duhet ta ngatërrojmë me të qenët një rob i thjeshtë. Përballë së vërtetës Muhamediane, perceptimi ynë mbi të vërtetat metafizike i ngjan perceptimit të një fëmije në krahasim me një të rritur. Sepse Hazreti Pejgamberi a.s. është një i zgjedhur në mes të krijesave dhe shënon kulminacionin e krijimit. Aq i madh është Resuli, sa të gjithë emrat e pejgamberëve janë grumbulluar në emrin e Tij të mrekullueshëm. Sheriati, pra, feja që ndan të mirën nga e keqja, u plotësua me Islamin që solli Ai.

Për të siguruar vazhdimësinë e sundimit të mbretërve mbahen fjalime, shtypen para dhe bëhen lutje. Por, pas pak kohe mbretëritë dhe sundimtarët e tyre fshihen nga skena e historisë. Fjalimet që mbahen për profetët nuk janë të tilla. Mbretëria e Profetë-

“(O Resuli im!) Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre!..”

(el-Enfal, 33)

ve dhe e trashëgimtarëve të tyre, është e vazhdueshme dhe e pavdekshme. Ata janë tek Allahu të pavdekshme, por janë të tilla edhe në zemrat e njerëzve. Ndërsa mbretëritë e sundimtarëve dhe pushteti i burrave të shtetit është kalimtar, pra një pushtet thjesht tokësor, prandaj janë të destinuara të shkatërrohen. Tekembramja, të gjithë kështu përfundojnë. Ndërsa Pejgamberët dhe velitë (miqtë e Allahut) janë udhërrëfyes për tek Allahu i Lartmadhëruar. Këta të fundit sakrifikuan gjënë e tyre të vdekshme për të Pavdekshmin, kështu që u bënë edhe vetë të pavdekshëm. Mbretëritë e tyre vazhdojnë edhe në jetën e varrit, madje edhe në atë të përtejmen. Në mihrabin e rreshtave që formojnë këta shpirtëra të përndritur, gjendet më i madhi i njerëzimit Hazreti Muhamed Musatafaja a.s.

Kështu që emri i çdo princi fshihet nga kujtesa, teksa emri i mbretit të dynjasë dhe të ahiretit, emri i Pejgamberit a.s. përjetësohet në tokë, në qiej dhe në zemrat e njerëzve. Kësisoj, është emri i princit të pashoq që ulur është në fronin e përjetësisë ai të cilit i duhet shkruar me shkronja dashurie që nuk fshihen kurrë nga zemra, dhe jo emrat e princërve tokësorë të mbretërive të zhdukura.

Në një ajet drejtuar mushrikëve, Allahu (xh. sh) thotë:

“(O Resuli im!) **Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre!..”** (el-Enfal, 33)

Në një kuptim, ky ajet flet për mirësitë dhe sihariqet që do të kenë besimtarët të cilët do të ruajnë në zemrën e tyre atë Qënie të Nurtë. Kjo do të thotë se, aq sa zemra e një besimtari është e mbushur me dashurinë për Resulullahun a.s., po aq larg është edhe besimtari vetë prej dënimit (azabit) të Allahut (xh.sh). Ky është betimi i Allahut të Lartmadhëruar. Pra, Allahu nuk do të na dënojë dhe nuk do të na shkatërrojë, për sa kohë që ne të kemi në zemër Pejgamberin (a.s.).

Velitë dhe vepërmirët e bëjnë të vezullojë edhe më tepër pasqyrën e shpirtit të tyre me dashurinë ndaj Profetit a.s., në atë mënyrë sa dalin në pah stolitë më të fshehta e më të bukura. Në pasqyrat materiale shihen vetëm gjërat që janë materiale (që kanë trup, forma dhe ngjyra). Ndërsa velitë dhe vepërmirët, me nurin e rrezatimit të Tij bëjnë të shkëlqejnë ndjenja të sinqerta, mendime, lutje, dritë hyjnore dhe mirësi të bollshme.

Bukuritë kërkojnë të shohin veten në pasqyrë. Ato kërkojnë sy dhe shpirtëra që dijnë t’i vlerësojnë e t’i duan. Edhe misteri i krijimit të universit, dhe misteri i krijimit të njeriut nga i Bukuri absolut, Allahu, lidhen pikërisht me këtë të vërtetë. Në një hadith kudsi thuhet:

“Unë isha një thesar i fshehur, deshta me u dijtë e me u dashtë.”

Që nga fillimi i krijimit, kur çdo gjë hyri në ekzistencë nga nuri i Tij, të gjithë pejgamberët duke filluar që nga Hazreti Ademi, bartën mirësitë dhe gjallëritë e nurit të tij me anë të rrugës së përfaqësimit.

Të gjitha bukuritë i përkasin Atij. Qëllimi i krijimit të tyre është pikërisht Ai. Çdo bukuri është vetëm një

reflektim i Tij. Nuk çel asnjë lule që të mos ketë diçka nga nuri i Tij! Tekembramja, mos të ishte Ai asnjë gjë nuk do të mund të fitonte formë dhe qenie. Ai përbën arsyen e egzistencës sonë…Ai është një gonxhe hyjnore e nurtë, që s'vyshket kurrë, po përkundrazi, me kalimin e kohëve i shtohet edhe më shumë freskija dhe njomështia.

Hazreti Mevlana shprehet:

"Xhebraili a.s. , shtriu vetëm njërin krah dhe përfshiu lindjen dhe perendimin. Kur Profeti a.s. e shikoi këtë dhe solli ndërmend madhështinë e Atij që i kishtë dhënë Xhebrailit a.s. këtë madhësi, i ra të fikët"

"Por, sikur Hazreti Pejgamberi a.s. të kishte hapur krahun e së vërtetës Muhammediane, të cilën asnjë mendje s'mund ta përfshijë, Xhebrailit do t'i binte të fikët e nuk do të mund të zgjohej më kurrë."

Ai është mbi të gjithë të dashurit, një krijesë e veçantë që meriton ta duam me çdo gjë. Ai është më i bukuri dhe më i virtytshmi, më i mëshirshmi i njerëzimit, Ai është i vetmi prijës dhe udhëheqës. Ai qe i aftë t'i bënte ta donin e të përlotshin për të ata njerëz të egër që varrosnin të gjalla vajzat dhe ia doli mbanë t'u mësonte atyre librin, misteret dhe urtësitë. Ta mbash atë mbi çdo gjë, ta duash atë me një dashuri të pashoqe, do të thotë të tregosh një përsosmëri imani. Kulminacioni i kësaj dashurie shprehet kështu në një hadith:

"Nuk ka besuar ashtu

siç duhet akoma, ai që nuk më do mua më shumë se prindërit, më shumë se fëmijët dhe më shumë se çdo njeri tjetër!.."

Ky hadith tërheq shumë vëmendjen e besimtarëve në lidhje me plotësimin e imanit, duke theksuar faktin se dashuria për Profetin a.s. është konteksti i kulminacionit të tij. Ata që qëndrojnë larg kësaj dashurie janë të privuar nga mirësitë dhe nga evoluimi i imanit. Fara e dashurisë rritet vetëm në dheun e dashurisë ndaj Tij. Ai është burimi i mirësive dhe i begative shpirtërore. Dashuria ndaj Tij është dheu ku u gjallëruan dhe u lartësuan në vlerën e xhevahirit shumë zemra të gurta, përmes së cilës shumë njerëz fituan vlerën e arit dhe të sermit përballë të tjerëve.

Të parët që lulëzuan në këtë tokë dashurie profetike ishin sahabet, që jetuan në një atmosferë të papërshkruar dashurie.

Ja një nga panoramat e kësaj dashurie, që pasqyrohet tek një bashkëkohëse e profetit:

Vajza e Ka'b-it, Nesibja r.a. kishte marrë pjesë në luftën e Uhudit, së bashku me myslimanët e tjerë. Teksa po u dërgonte ujë myslimanëve të plagosur, me enët që i kishte bërë me duart e veta, ajo vuri re se ushtarët po shpërndaheshin nga disfata që po pësonin. Ajo vrapoi menjëherë drejt Profetit a.s., me dëshirën që ta ruante nga shigjetat dhe gurët

“Nuk ka besuar ashtu siç duhet akoma, ai që nuk më do mua më shumë se prindërit, më shumë se fëmijët dhe më shumë së çdo njeri tjetër!..”

që hidheshin drejt Tij. Kësisoj, ajo mori dymbëdhjetë plagë në trup, duke mbrojtur Profetin a.s..

I dërguari i Allahut a.s. e pat përmendur me lavd këtë sahabije, duke thënë:

“Sot Nesibja i ka kaluar shehidët (dëshmorët) filan e filan.”

Me heroizmin e shfaqur në luftë, heroizëm që buronte nga vetëdija e besimit, emri i Nesibes hyri në historinë Islame si emri i një prej grave më shembullore, duke merituar kështu përgëzimet dhe lavdërimet e të Dashurit të Allahut a.s. .

Një tjetër manifestim dashurie:

Sevbani r.a., i cili ndodhej i pranishëm gjatë një ligjërate të Pejgamberit a.s., po shihte thellë dhe i habitur. Dukej qartë se ndodhej edhe në një gjëndje të vështirë shpirtërore. Gjendja e tij ia tërhoqi vëmendjen Hazreti Pejgamberit, i cili me plot mëshirë e pyeti:

“Çfarë ke o Sevban?”

Me shpirtin e tij të përndezur nga dashuria për Resulullahun a.s., Sevbani r.a. u përgjigj:

“Kurban t’u bëfshin babai im, nëna ime dhe kjo zemra ime o Resulullah! Malli për ty më ka djegur e më ke pjekur aq shumë, sa çdo çast që kalon pa nurin tënd më duket mërzi e vuatje. Kur kjo është kaq e rëndë në dynja, po në ahiret? Atje, ju do të jeni së bashku me Pejgamberët e tjerë. Kurse vendodhja dhe përfundimi im nuk dihet akoma! E për më tepër, nëse unë shkoj në xhehennem privohem krejtësisht nga mundësia për të të parë Ty. Kjo gjendje po më shkatërron e po më përvëlon, o Resulullah!”

Hazreti Peejgamberi a.s. i dha sihariqin sahabëve që shpesh here, ashtu si Sevbani, shprehnin fjalë të tilla malli, duke iu dhanë qetësi shpirtërave të dashuruar pas Tij:

“Njeriu është me atë që do…”

Kur Ai ndërroi jetë, mërzia e sahabëve arriti kulmin. Ata ishin të ndezur e të shkrirë pas Resulit a.s., ishin si qirinj të shkrirë nga ndezja. Ata që deri dje nuk mund të rrinin pa e parë të paktën një herë në ditë, si do të mund të jetonin në këtë jetë pa praninë e Tij fizike? Duke e mos mundur ta duronte dot atë ndarje dhe atë mall mall, Abdullah bin Zejdi r.a. ngriti duart lart dhe u lut me tërë forcën e shpirtit:

“O i Madhi Zot! M’i merr krejt këta sytë e ballit! Çfarë më duhen sytë e ballit kur nuk do të mundem ta shoh më të dashurin tim të zemrës, Hazreti Pejgamber Mustafanë!..” Pas kësaj lutjeje, pikërisht në atë çast, atij iu fik shikimi dhe u verbua nga Zoti, sipas vetë dëshirës së tij.

Fjalët tona janë shumë të varfëra për ta shprehur plotësisht dashurinë e sahabëve për Profetin a.s.. Ja disa shembuj nga



ai det i tërë shembujsh:

Enesi r.a. tregon:

"E pashë një ditë Resulin tek berberi. Sahabët e kishin rrethuar Atë. Ata nuk linin t'i binte në tokë as edhe një fije floku dhe grindeshin me njëri-tjetrin për këtë."

Sahabët shdërronin në objekte dashurie dhe konsideronin burim mbarësie çdo gjë të profetit, rrobat, madje edhe fijet e flokëve apo të mjekrrës. Edhe në luftë e kanë mbartur këtë shpresë. Për këtë mund të sjellim shembullin e Halid bin Velidit r.a., i cili kishte fshehur në sarëkun (shall që lidhej për kokë) e tij disa fije floku të Hazreti Pejgamberit. Sipas disa transmetimeve, thuhet se Halidi r.a. e humbi sarëkun e tij në luftën e Jermukut. Ai urdhëroi menjëherë ushtarët:

"Ma gjeni medoemos atë!"

E kërkuan, por nuk e gjetën. Hazreti Halidi i urdhëroi sërish ata që t'ia gjenin. Pasi kërkuan edhe një herë, e gjetën atë. Por çfarë të shihnin: një sarëk krejt i vjetëruar. Kjo gjë shkaktoi habi tek sahabët. Që t'ua shuante kureshtjen atyre, Hazreti Halidi iu drejtua me këto fjalë:

"Një ditë Resullahi kishte shkurtuar flokët. Sahabët i morën menjëherë ato. Unë arrita të marr vetëm disa fije floku nga balli i Tij i ndritur, të cilat pastaj i vendosa në sarëkun tim. Kjo më solli kaq mbarësi, sa që në çdo luftë dola fitimtar. Suksesi im në çdo luftë që kam drejtuar, lidhet padyshim me dashurinë për Hazreti Pejgamberin."

Siç vërehet edhe nga shembujt e mësipërm, dashuria ndaj Profetit a.s. kishte jo vetëm manifestime të brendshme, por edhe të jashtme. Manifestimet e dashurisë formësoheshin edhe në realitetin e dukshëm. Një shembull shumë i mirë i kësaj është edhe Shteti Osman. Në atë kohë ata e emërtonin shtetin e tyre si "Shteti Muhamedian". Një nga arsyet që bëri të mundur jetëgjatësinë e këtij shteti në krahasim me shtetet e tjera tjera islame, përveç arsyeve të tjera, është edhe dashuria e madhe që kultivonte për më të Dashurin e Allahut a.s. .

Shembujt e mëposhtëm e pohojnë në mënyrë të qartë këtë dashuri:

Kur ndërtoi rrugën hekurudhore të Hixhazit, vepër me të cilën synonte lehtësimin e komunikimit të njerëzve me vendet e shenjta, Abdulhamiti II u mundua ta realizonte këtë vepër në përshtatje me sunnetin e Hazreti Resulit. Ai urdhëroi që stacionet e hekurudhës të ngriheshin në ato vende tek të cilat ishte ndalur zakonisht të pushonte Profeti a.s.. Kështu, edhe me rrugën hekurudhore të cilën e shtriu deri në Medine, ai e shprehu dashurinë e tij për Hazreti Pejgamberin.

Ashtu sikundër hëna dëshmon ekzistencën e diellit, ashtu edhe pejgamberët e velitë dëshmojnë Nurin Muhamedian. Për këtë arsye, në çdo zemër ku fshihet kjo dashuri dhe ky ashk, fillon të shfaqet një rrezatim përdëllyes hyjnor, si rrezatimi i dritës në pasqyrë. Nganjëherë kjo shkëndijë hyjnore ndizet aq fort, sa që shpirtërat përjetojnë një kënaqësi të pamasë.

Shembulli i Bilalit r.a. është shumë domethënës:

Bilali r.a. nuk kishte asnjë degë ku të kapej, nuk kishte asnjë të afërm ku të strehohej dhe nuk kishte asnjë mik me të cilin mund të ndante hallet e tij. Ishte thjesht një skllav. Por erdhi një ditë kur ai hyri në fenë islame dhe me sakrificat që bëri në mbrojtje të tevhidit, ai u shndërrua në një shembull të përkryer përpjekjesh të pashembullta në ruajtje të imanit.

Ai shikoi nurin e fytyrës së të dërguarit të Allahut

“Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!”

a.s., u dogj dhe hyri në kopshtin e dashurisë. Ai ishte bërë i tëri pjesë e Tij. Por pronari i Bilalit r.a., i cili ishte ende larg të vërtetës islame, e torturoi atë duke e shtrirë në rërën përvëluese të shkretëtirës, mes atij dielli të çmendur, duke e bërë këtë thjesht ngaqë Bilali kishte pranuar islamin. Ai e kamxhikoi trupin e tij të zhveshur. Nga lëkura e tij e zezë shpërtheu gjaku i kuq. Njerëzit injorantë që ndodheshin aty, i thanë:

“O skllav i ndyrë! Kthehu kah ne dhe shpëto!”

Ndërsa Hazreti Bilali, ashtu i shtrirë në rërën përvëluese të shkretëtirës, sokëlliu si një luan i plagosur dhe iu hakërrye atyre më tërë fuqinë e tij, duke dëshmuar njësinë.

Ato që ishin përreth tij vazhduan ta godisnin pa mëshirë. E goditën, e goditën… Nuk u mjaftuan me këtë, por i lidhën edhe një litar në fyt dhe e tërhoqën zvarrë. Por Bilali r.a. ishte strehuar mirë nën mburojën e dashurisë për Allahun dhe për Resulin e Tij, pavarësisht të gjitha vuajtjeve që po përjetonte. Si të mos i ndjente fare torturat që po i bënin, zemra e tij mbushej e përmbushej me dashurinë për Allahun dhe për më të Dashurin e tij. Zemra e tij ishte zgjeruar aq shumë sa kishte kapërcyer përmasat e të gjithë botërave, pavarësisht se gjendja e tij e kësaj bote ishte e mjerueshme dhe nuk kishte as edhe një kasolle për të futur kokën.

Kjo dashuri dhe ky ashk e lartësoi Bilalin nga skllavëria e deri në fronin mbretëror të shpirtit. Ai u bë muezini i Hazreti Pejgamberit. Këtë dashuri ai e kishte në buzë edhe në çastet e fundit të jetës së tij, derisa fluturoi në botën tjetër i buzëqeshur dhe duke thënë:

“Gëzohuni, gëzohuni!.. Unë jam duke shkuar tek Resulullahu a.s. …”

Kështu, nëse një njeri merr rriskun e tij nga një mik i Allahut, duke reflektuar kështu dritën dhe të vërtetën e Resulullahut a.s. do të thotë se e ka marrë atë nga vetë i Dashuri i Allahut. Ashtu sikurse shembulli i një qiriu të ndezur nga një tjetër qiri. Flaka që ndez kandilët dhe ndriçon përreth, është e njëjta flakë. Edhe nëse njeriu përndritet nga kandili i fundit, ai nur reflekton vazhdimisht shkëlqimin e dritës së burimit të parë. Prandaj, me dashje ose pa dashje, njeriu duhet të jepet pas rrezatimeve hyjnore që sheh tek një tjetër, e vërteta qëndron në faktin se bukuria pas së cilës dashurohemi dhe mahnitemi në planin shpirtëror, është bukuria e Allahut të Lartmadhëruar, sepse ato janë reflektimet e mrekullueshme që Allahu i Lartmadhëruar hedh mbi krijesat e veta. Nuk ka as edhe një grimcë dyshimi se reflektimi më intensiv i rrezatimeve hyjnore është Hazreti Pejgamberi. Kjo është arsyeja pse themi se Hazreti Pejgamberi a.s. është e vetmja urë e sigurtë që të shpie tek Allahu i Lartmadhëruar.

Shkalla e dashurisë manifestohet në vepra. Bindja që ne shfaqim ndaj Tij si dhe zbatimi i sunnetit të Tij, tregojnë shkallën tonë të dashurisë. Në ajetin 56 të sures Nur thuhet:

“Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!”

Atmosfera shpirtërore në adhurim, finesa në veprime, edukata ne sjellje, bukuria në shpirt, rrezatimi i nurtë në fytyrë, rrjedhshmëria në shprehje, delikatesa në ndjenja dhe thellësia në shikim, janë vetëm disa rrezatime shpirtërore të dashurisë së Asaj Qënieje të Nurtë.

Sa bukur shprehet Hazreti Mevlana:

“Eja o zemër! Bajrami i vërtetë është bashkimi me Hazreti Pejgamberin. Sepse ndriçimi i universit buron nga bukuria e asaj qenieje të lavdishme”.

Një qasje juridike islame ndaj të drejtës autoriale

Mr.sci. Hamur Sofiu

S'ka dyshim se çështja e të drejtës autoriale është një prej çështjeve shumë të ndjeshme e cila diskutohet vazhdimisht nga studiues të ndryshëm. Andaj edhe dijetarët e së drejtës islame janë marrë dhe kanë gjurmuar në lidhje me këtë çështje, duke shprehur kështu edhe mendimet e veta. E themi me plot përgjegjësi se kjo është një temë ende e hapur e cila kërkon diskutime e studime, ngase përbën një problematikë të gjerë. Kësisoj, ne do të mundohemi të përmendim disa nga mendimet e juristëve myslimanë që janë shprehur për këtë temë. Tjetra që duhet të rikujtojmë, është se natyrshmëria e fesë islame është e atillë që i përgjigjet çdo kohe dhe çdo vendi, kështu që çdo problematike që paraqitet duhet t'i jepet shpjegimi dhe sqarimi në lidhje me qëndrimin që ka sheriati ndaj saj.

Dihet shumë mirë se në aspektin e përgjithshëm nuk lejohet të dëmtohet askush dhe se askujt nuk mund t'i merren të drejtat që ia ka përcaktuar sheriati islam, andaj edhe e drejta e autorësisë është një e drejtë e paceneshme sipas të drejtës islame.

Duhet ta kemi parasysh se në këtë punim shumë modest nuk do të shprehim mendimin tonë personal, por do të mundohemi të cekim mendimet e dijetarëve meritorë islamë.

Këtë punim do të përpiqemi ta shtjellojmë sipas kësaj ndarje:

1. Shitja e të drejtës autoriale,
2. Shitja e të drejtës autoriale vetëm për botim,
3. Trashëgimia e të drejtës autoriale dhe shitja e saj,
4. Të marrët shpërblim dhe të përfituarit nga punimi autorial,
5. Përfundimi

1. Shitja e së të drejtës autoriale:

Pa kurrfarë diskutimi dihet se ai që shkruan një libër apo edhe artikull, has plot vështirësi, mundohet dhe shpenzon kohë e angazhim të madh. Kështu, menjëherë na del përpara çështja nëse a do të mundet në këtë rast autori të marrë shpërblim dhe kompensim, ashtu sikundër merr çdo mje-

shtër apo punëtor që kryen ndonjë punë? Ashtu sikundër punëtori apo mjeshtri ka të drejtën të kërkojë kompensim apo shpërblim për mundin dhe angazhimin që ka bërë, në të njëjtën mënyrë edhe autori e ka këtë të drejtë, e për më tepër, atij i përket e drejta të vendosë se kujt dëshiron t'ia ofrojë të drejtën autoriale dhe anasjelltas kujt nuk dëshiron t'ia japë këtë të drejtë.

Kur shikojmë mendimet e dijetarëve për marrjen e kompensimit në lidhje me punime autoriale, vërejmë se dijetarët në këtë aspekt ndajnë mendimet e tyre:

1. Disa nga dijetarët janë të mendimit se nuk lejohet të shitet apo të merret kompensim për të drejtën autoriale.

2. Disa janë të mendimit se lejohet shitja dhe kompensimi për drejtën autoriale. P.sh.Në librin "Bustanul Muhadithin" transmetohet se disa nga dijetarët e hadithit e kanë lejuar marrjen e kompensimit.[1] Po ashtu, duhet të përmendim se dijetari Ebu Is'hak esh-Shiraziu ka dhënë fetva se marrja e kompensimit është i lejuar.[2]

2. Ka disa prej dijetarëve që janë të mendimit se kjo nuk është e ndaluar, por është veprim i papëlqyer (mekruh).

Mendimi mbizotërues: Mendoj se mendimi më i zbatueshëm dhe më i arsyeshëm për rrethanat e sotme është se lejohet marrja e kompensimit dhe shitja e të drejtës autoriale sipas kushteve që vendosin të dy palët, dhe se parashikohet që kushtet të jenë në përputhje e të pranuara nga e drejta e sheriatit islam.

Të drejtën e dhënies leje për botim nuk e ka askush përpos vetë autorit. Nga kjo kuptohet se autori jep lejen për botim dhe se ka të drejtë përfitimi nga botimi. Po ashtu, të drejtën për përcaktimin e numrit të kopjeve të botuara e jep vetëm autori dhe se ai është i vetmi që mund ta bëjë një përcaktim të tillë. Përcaktimi i çmimit të shitjes është e drejtë e botuesit, ndërsa autorit nuk i lejohet të ndërhyje në këtë çështje. Arsyeja është se kopjet e librit janë mall i vlefshëm nën pronësinë e botuesit dhe se çdo pronar vepron lirshëm me pasurinë dhe pronën e vet[3].

2. Shitja e të drejtës autoriale vetëm për botim:

Kur ndodh që të shitet e drejta për botim nga ana e autorit, nuk lejohet që ai i cili e ka blerë këtë të drejtë t'ia japë të drejtën për botim edhe ndokujt tjetër, ngase kjo është e papranueshme, duke u bazuar në hadithin e të Dërguarit s.a.ë.s., i cili e ka ndaluar shitjen e mallit që nuk është në pronësinë tënde: "Mos e shit atë që nuk është në pronësinë tënde" (ky hadith gjendet në sunenin e Ebu Davudit, në Xhamiun e Tirmidhiut dhe në koleksionet tjera të hadithit). Me këtë hadith vërehet qartë se kjo gjë ndalohet. Në këtë rast, me lejen që i jep tjetrit për ta botuar, botuesi bën një marrëveshje me një mall që nuk i përket atij. Duhet theksuar se ka nga dijetarët hanefitë që e kanë lejuar një shitblerje të tillë, por mendimi i zbatuar është se kjo shitblerje është e ndaluar dhe se të këtij mendimi janë edhe dijetarët e medh'hebe tjera.

Nëse botuesi merr leje për botim nga botuesi që ka pasur leje, kjo na bën neve të mendojmë se në këtë rast botuesi i parë mund të ketë marrë ndonjë shpërblim për këtë leje dhe se tashmë kemi të bëjmë me kamatë, akt i cili dihet se është rreptësishtë i ndaluar.

Imam Maliku r.a. dhe të tjerët kanë zgjedhur shpjegimin se askujt përpos autorit nuk i lejohet të marrë kompensim-shpërblim, ngase autori në këtë rast është pronari i parë, ndërsa botuesi është i dyti apo edhe i treti[4].

3. Trashëgimia e së të drejtës autoriale dhe shitja e saj:

Në shpjegimet e mësipërme vumë në dukje se shkrimi

1. Abdul Aziz ed-Dehelvij, Bustanul Muhadithin, pa vit dhe vend botimi, fq. 35
2. Mukaddimetu Ibni Salah , botuar në Bombaj 1358 h. fq. 56
3. Muhammed Burhanduddin es-Sunbuheji: Kadaja Fikhjiet Muasiretin, Dar - tul Ulum, Bejrut, Darul Kalem, Dimeshk 1408 h. 1988, fq. 39
4. po aty, fq. 42-43

autorial është pasuri me vlerë, një lloj pasurie që trashëgohet, sipas ligjeve të sheriatit. Atë shpërblim që ka pasur ta marrë autori, pas vdekjes së tij e merr trashëgimtari.

Ndërsa sa i përket shitjes së trashëgimisë së drejtës autoriale, ligjet islame nuk e lejojnë, ashtu sikur nuk lejojnë t'i jepet leje cilitdo trashëgimtar të autorit që ta shesë të drejtën e trashëgimisë.

4. Të marrët shpërblim dhe të përfituarit nga punimi autorial:

Duke u shprehur në mënyrë të përgjithshme, themi se nëse plotësohen të gjitha kushtet e marrëveshjes në mes të autorit dhe klientit dhe njëkohësisht asnjë pikë e marrëveshjes nuk bie në kundërshtim me parimet e sheriatit, lejohet shpërblimi dhe përfitimi material.

Shënim:

Këtu mund të lindë një pyetje: a lejohet apo jo botimi i një libri pa lejen e autorit? Vërtetë nuk hasin në ndonjë shkrim që sjell argumente të forta që nuk e lejojnë një veprim të tillë, mirëpo nëse autori e ka të regjistruar librin në përputhje me ligjet e shtetit, atëherë mbetet që për këtë të përcaktohen rregulla nga vetë shteti; nëse kjo bie ndesh me marrëveshjen që ka autori me shtetin, sigurisht se do të konsiderohet vepër e ndaluar edhe në sheriatin islam, ngase vetë prijësi mund të penalizojë ndonjë çështje nëse sheh se në të është interesi i përgjithshëm i shoqërisë islame. Përkundër kësaj, autori nuk ka të drejtë të përcaktojë ndonjë gjobë në të holla për shkak të botimit apo shitjes pa lejen e tij, por ndëshkimi mbetet në dorë të qeverisë, sipas ligjeve të përcaktuara.[5]

5. Përfundimi:

Duke analizuar mendimet e dijetarëve-juristë islamë, qofshin të hershmit apo të mëvonshmit, na dalin në pah këto rezonime:

1. Se çdo punim autorial është një lloj pasurie që ka vlerë, andaj autori është pronari i parë dhe kryesor i kësaj pasurie.

2. Se e drejta autoriale është një prej të drejtave që nuk duhet të cenohet në asnjë mënyrë.

3. Se e drejta autoriale mund t'i shitet botuesit, por edhe mund t'i ofrohet dikujt për studim, me kushtin që më pas t'i rikthehet të zotit, i cili edhe për këtë mund të marrë kompensim.

4. Se autori ka të drejtën e përcaktimit të numrit të kopjeve për botim, ndërsa të drejtën e përcaktimit të çmimit e ka vetë botuesi, pa pasur të drejtë të ndërhyje autori.

5. Kur ndodh qe autori i shet një kopje të librit dikujt, atëherë ai ka të drejtë t'i shesë edhe dikujt tjetër, ndërsa botuesi i cili ka blerë të drejtën autoriale nuk mund t'i shesë ndonjë botuesi tjetër.

6. Autori nuk ka të drejtë të përcaktojë ndonjë gjobë materiale ndaj botuesit që boton librin pa të drejtën autoriale, por kjo mbetet në kompetencën e shtetit se si ta ndëshkojë botuesin.

5. po aty: fq. 45-46

Nëse do t'ju vinte Pejgamberi

Nëse do ndodhte që vizitë t'ju bante Pejgamberi,
Vetëm për disa ditë,
Dhe sikur ai çast të vijë;
Jam kureshtar me dijtë çfarë kishim me ba?
Ma merr mendja se do t'i jepnim dhomën ma të mirë
Këtij mysafiri kaq të nderuem
Dhe do t'i ofronim ma të mirin ushqim
ma të mirën pije që kemi në shtëpi.

Jam i sigurtë se kënaqësia që do të ndjenim
Tue i shërbye atij zotnije
Dhe lumturia që do të na jepte prania e tij
Në shtëpi
S'do mund të krahasohej me asgja tjetër.

Por megjithatë, prapë mendoj
Se kur ta shihnim tue ardhë në shtëpinë tonë
A do ta prisnim në derë?
Pa e marrë brenda atë mysafir të nderuar, pa i thanë "Urdhno o Resulullah!"
Jam kureshtar me dijtë çka do të banim para se me ia shtri krahët
Atij mysafiri të nderuem e me i thanë "mirseerdhe o Resul!".

A do t'i fshihnim gazetat dhe revistat që mbajmë zakonisht në tryezë
Për me vu Kuranin në vend të tyre?
A do ta mbështillnim me ndonji mbulesë televizorin,
në të cilin shohim gjithfarë programesh me njerëz lakuriq?
Apo çilembyll sytë do ta merrnim në bodrum a ta fshihnim në izbe?

Apo do të vraponim me e fikë shpejt, ende pa u zemërue Ai?
Apo do ta mbyllnim radion, tue shpresue se ende s'ka ndigjue gja ai mysafir i nurtë,
Po videokasetat që sholim në televizion e që të skuqin fytyrën nga turpi?
Me duket se harruam kasetat e muzikës që i kemi renditur nji mbi nji në raftin e shtëpisë.
A do t'i hiqnim edhe ato menjëherë, e në vend të tyre të vendosnim libra Hadithi.

Jam shumë kureshtar me e dijtë
A do t'i jepnim leje menjëherë këtij mysafiri të shtrenjtë
Për të hy në shtëpinë tonë?
Apo do të vraponim sa andej këndej?
Apo do t'i thonim "A mundesh me pritë pak?"
E do ta linim me pritë në derë?

Jam shumë kureshtar...
Nëse Pejgamberi ynë aq shumë i dashtun
Do të kalonte disa ditë në shtëpinë tonë
A do të vijonim me ba gjanat e përditshme?
A do të flinim deri në lindje të diellit, a deri dhe ma vonë?
A do t'i vazhdonim skenat e shamatave dhe të zhurmave në shtëpi?
Apo do të fillonim pas disa orëve me u mërzitë e me u thye?

Jam shumë kureshtar me dijtë...
A kishim me mujtë që pa u mrrolë në ftyrë
Me i falë të gjitha kohët e namazeve me pjestarët e tjerë të familjes?
A do të mund të përgatiteshim që herët për namazin e sabahut
Dhe a do mundeshim me i ba me lëvizë prej shtratit vajzën a djalin
që e kanë arritë moshën e fejesës?
Ose ma mirë me thanë
Kur të jemi tue i nxjerrë ujë Mysafirit të shtrenjtë,
Ku do ta mshehim djalin tonë 15-vjeçar, balli i të cilit ende se ka provue sexhden?
Apo do ta dërgojmë për disa ditë atë në ndonji hotel, ose tek të afërmit?

A thue ka se si...
Me mujtë me e çue profetin në ato vende ku e kishim ba në plan me shkue para se Ai me ardhë?
Me pa mënyrën tonë të sjelljes kur kamarieri i vesnur shik do t'i thotë
Vajzës tuaj 17-vjeçare "Çfarë dëshiron të marrësh?"

A thue ka se si
Me mujtë Profeti me ndejt tre-katër orë me ne në tryezën ku jemi ulë?
Apo do ta sillnim në shtëpi për me pushue?

Jam tue mendue.
Dhe jam tue mendue a thue se jam tue e pa me sy.
Me i tregue se si i kalojmë ne 24 orët
Kur për do ditë si mysafir të na vijë ai i dashtuni Resul.
Djalin tonë me ia tregue kur hyn në shtëpi tue thanë "Bonjour"
Vajzën tonë që zbret nga makina me minifund.
E mandej me i thanë "Unë nuk kam asnji faj në lidhje me këtë Ja Resulullah!"
Nanat dhe baballarët që vdesin e ngjallen...
Jam tue përfytyrue
Njerëzit që do të vijnë në shtëpi.
Hymjet, bisedat, ardhjet e miqve që s'dijnë gja për praninë e Profetit aty.

Pra për atë që do të vijë për do ditë si mysafir në shtëpinë tonë,
Jam kureshtar me dijtë se çfarë qëndrimi do të mbanim ndaj Profetit.
Jam kureshtar me dijtë si do ta prisnim e si do ta përcillnim Pejgamberin aq të dashtun.

Nëse Pejgamberi do të kalonte disa ditë me ne së bashku,
A do të vijonim me ba prapë të njëjtat punë që bajmë përditë?
Apo do të merrnim frymë lirisht pasi të përfundonte vizita e Profetit e Ai të ndalnej prej nesh?

Po, sikur Pejgamberi i ynë i dashtun të vijë me kalue pak kohë me ne;
A do të shkatërrohet jeta jonë?
Apo, po apo...

Shenjë e dashurisë ndaj Profetit a.s.

Naim Drijaj

Për nga rëndësia, dashuria për Pejgamberin (a.s.) vjen menjëherë pas dashurisë që besimtari duhet të ushqejë ndaj Allahut xh.sh., madje mund të themi se dashuria ndaj Pejgamberit a.s. buron nga dashuria jonë për Allahun. Ai që e do Allahun, padyshim, e do edhe Pejgamberin a.s., sepse Allahu xh.sh. e ka bashkuar emrin e Vet hyjnor me emrin e Tij:"La ilahe ilallah Muhamedur-resulullah".

Nuk mjafton të thuhet vetëm me gojë se unë e dua Pejgamberin a.s.. Por, pas këtij pohimi kërkohet edhe shkuarja pas mësimeve të tij dhe praktikimi i tyre. Allahu xh.sh. thotë: "Thuaj! Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë gjynahet tuaja. Allahu falë dhe mëshiron shumë". (Ali Imran, 31)

Sehl ibn Abdullah ka thënë: "Shenjë e dashurisë së Allahut është të duash Kuranin. Shenjë e dashurisë së Kuranit është të duash pejgamberin. Shenjë e dashurisë së Pejgamberit është të duash sunetin e tij.

Enes ibn Maliku r.a. tregon se një njeri e ka pyetur Pejgamberin a.s. se kur do të ndodhë Dita e gjykimit. Pejgamberi a.s. e pyeti se çfarë kishte përgatitur ai për Ditën e gjykimit. Personi iu përgjigj: Për Ditën e gjykimit nuk kam përgatitur shumë gjëra me përjashtim të obligimeve, por e dua Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Pejgamberi a.s. i tha: Ti do të jesh në botën tjetër së bashku me atë që e do. (Buhari) Dashuria është baza e çdo vepre në këtë jetë. Çdo vepër në botë buron nga dashuria dhe dëshira. (Kaide fil mehabbe, Ibn Tejmijje 2/ 193 dhe 202)

Në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi Pejgamberi a.s. ka thënë: "Asnjëri nuk ka besuar plotësisht përderisa të mos më dojë mua më shumë se babanë, fëmijët e tij, veten dhe njerëzit mbarë".

Në luftën e Uhudit një gruaje myslimane nga fisi Beni Dinar, i vdiqën në luftë burri, vëllai dhe i ati. Kur e lajmëruan dhe u përpoqën që ta ngushëllonin, ajo u tha njerëzve që e rrethonin: "Çfarë i ka ndodhur Pejgamberit a.s.?" I thanë: "Ai është gjallë." Tha: "Ma tregoni që ta shoh. Kur e pa se ai ishte i gjallë tha: "Çdo fatkeqësi është e parëndësishme përpara fatkeqësisë së humbjes tënde". (Siretu Ibn Ishak, 2, 99).

Omer ibn Hattabi r.a. një herë i tha Pejgamberit a.s. : "O i Dërguar i Allahut, vërtet unë të dua më shumë se çdo gjë, përveç vetes time! Pejgamberi a.s. tha: "Jo, pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ti nuk më do mua me të vërtetë në qoftë se e do veten më shumë se mua." Omeri r.a. tha: "Pas këtij çasti, pasha Allahun, ti je më i dashur për mua se vetja ime!" Pejgamberi a.s. tha: "Tani po, o Omer." (Buhari)

Dashuria ndaj Pejgamberit a.s. bën të mundur që besimtari të shijojë ëmbëlsinë e (imanit) besimit. Transmetohet

nga Enesi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush i zotëron tri gjëra ai do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: "Njëra prej tyre është ta duash Allahun dhe të dërguarin e Tij me shumë se çdo gjë tjetër". (Buhariu dhe Muslimi)

Kur Hubejb ibn Adij, u zu rob pas kurthit që i ngritën myslimanëve disa fise politeiste, mushrikët e pyetën pak përpara momentit të ekzekutimit: "A do të dëshiroje që në këtë çast, në vendin tënd të ishte Muhamedi a.s.? Dhe përgjigjja e tij ishte e prerë dhe e qartë: "Jo, Vallahi nuk do të pranoja që, në këmbim të shpëtimit tim, atij t'i ngulej qoftë edhe një gjemb në këmbë!" Pastaj mushrikët, armiqtë e Allahut dhe të pejgamberit, vendosën ta ekzekutojnë. Hubejb ibn Adij r.a i ngrit duart nga qielli e tha: O Allah nuk mund ta përshëndes për të fundit herë, të dashurin Tënd a.s., prandaj dërgoja Ti përshëndetjen time atje ku ndodhet. Muhamedi a.s. gjendej me shokët e tij kur ata dëgjuan se ai tha: Të përshëndes edhe unë ty o Hubejb. Të habitur, ashabët e pyetën të dërguarin e Allahut se ç'kishte? Ai me lot në sy u tha: Hubejbi ra shehid, por në çastin e fundit të jetës nuk harroi të më dërgonte selame. Allahumme sal-li ala Muhammedin ue ala ali Muhamed.

Allahu xh.sh. në Kuran urdhëron e thotë: "Thuaj (o i dërguar): "Thuaj: "Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria jua, që e kini fituar, tregtia – për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë – në të cilat e ndieni veten rehat, u janë më të dashura se sa Perëndia, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa ta sjellë vendimin Perëndia. E, Perëndia, nuk don ta udhëzojë në rrugën e drejtë popullin e korruptuar." (Tevbe, 24) Kadi Ijad në komentimin e këtij ajeti thotë: Mjafton kjo si nxitje , përkujtim, udhërrëfim dhe argument për obligueshmërinë e dashurisë ndaj të Dërguarit a.s. rrezikun që mban kundërshtimi i saj dhe faktin se vetëm i Dërguari i Allahut. a.s. (pas Allahut) meriton këtë dashuri. Atyre që i japin përparësi pasurisë, familjes dhe fëmijëve Allahu u kërcënohet duke ua cekur caktimin e Allahut (Dita e gjykimit ose dënimi në këtë botë) dhe duke i numëruar në radhët e njerëzve të prishur që Allahu xh.sh. nuk i udhëzon dot. (Esh-Shifa bi Ahbaril Mustafa 2/563)

Imam Kurtubi ka thënë: "Ky ajet është argument i qartë për domosdoshmërinë e dashurisë ndaj Allahut, pejgamberit dhe nuk ka mospajtim në këtë tek umeti. Duhet që kjo dashuri t'i paraprijë çdo dashurie tjetër."

Cilat janë shenjat se e duam Pejgamberin a.s.?

1. Pasimi i tij.
2. Përmendja e tij.

Transmetohet nga Abdurrahman Bin Avfi se ka thënë: "Shkova njëherë tek Pejgamberi, a.s. dhe e gjeta në sexhde ku qëndroi shumë gjatë. Pastaj tha: "Më erdhi Xhibrili dhe më tha: Kush përcjellë salavat mbi ty, unë do t'i përcjelli salavate atij. Kush përcjellë selame mbi ty, unë do t'i përcjellë selame atij. Për këtë arsye qëndrova në sexhde për ta falënderuar Allahun. (Transmeton Hakimi dhe Ahmedi. Albani thotë se hadithi është sahih)

3. Të vepruarit sipas sunnetit të Tij
4. Njohja e jetës së pejgamberit s.a.

Është e vërtet se njeriu e do më shumë atë që e njeh se sa atë që nuk e njeh. Njeriu më shumë pikëllohet në rast fatkeqësie për atë që e njeh se sa për atë që nuk e njeh. Njohja e jetës së pejgamberit a.s. është obligim sepse atë e kemi obligim ta marrim për model e nuk ke mundësi ta marrësh dikë për model shembull duke mos e njohur.

Ebu Bekri r.a ishte ai që e shoqëroi pejgamberin s.a.v.s për në Medinë gjatë hixhretit. Deri sa strehoheshin në shpellën Theur, pejgamberi s.a.v.s kishte vendosur kokën e tij a.s të nderuar në prehrin e pastër të Ebu Bekrit r.a për të pushuar. Pas një kohe pejgamberit s.a. i ranë ca pika lot në fytyrën e ti. Ai u zgjua dhe tha: "ç'është kjo o Ebu Beker? Asgjë, asgjë o pejgamber i Allahut vetëm pusho. Pasi pushoi pejgamberi s.a.v.s u zgjua prapë e pyeti Ebu Bekrin se ç'kishin ata lot që i ranë në fytyrë? Ebu Bekri iu përgjigj: lotët më pikuan ngase një gjarpër më kafshoi në këmbë. E pse s'u largove nga ai e pyeti pejgamberi a.s. Jo, jo nuk desha të shqetësoi ty o i dërguar i Allahut. Atëherë pejgamberi a.s bëri lutje për të dhe o fërkoi këmbën Ebu Bekrit me çka menjëherë iu ndal dhimbja.

Omer ibn Hattabi r.a. i ka thënë Abbasit, axhës së Pejgamberit a.s.: "Bëhu musliman, sepse vall-llahi, më e dashur te unë është të bëhesh musliman ti sesa Hatabi. Sepse Abbasi ishte më i dashur tek Pejgamberi a.s." (Tefsir Ibn Kethir, 2/326-327).

Amr ibnul-Asi pasi pranoi Islamin tha se asnjë njeri më parë nuk kishte urrejtur më shumë se Muhammedin a.s. por kur ai pranoi Islamin nuk kishte njeri mbi fytyrë tokës që e donte dhe respektonte më shumë se atë. Ai tha: "Sikur ju të më pyetni mua t'ua përshkruaj Pejgamberin a.s, nuk do të kisha mundësi, sepse unë nuk pata mundësi asnjëherë t'i mbush sytë e mi nga drita e tij".

Urvetu ibnu Mes'udi u tha Kurejshitëve: "O popull! Më dërguan te Kisraja (mbreti i persianëve) dhe tek Kajseri (mbreti i Romakëve), por nuk e pashë njeri që e respektonin njerëzit siç e respektonin Muhammedin a.s. ndjekësit e tij.

Obligimet e Pejgamberit a.s. sipas Kuranit

Gençer Devvari

Besimtarë ju keni në të Dërguarin e Allahut shembullin më të lartë për ata që shpresojnë të takohen me Allahun dhe ditën e ringjalljes, si dhe për ata që e përmendin shumë Allahun.

Muhammedi (a.s) ka qenë një njeri i zakonshëm si të tjerët, por dallimi i tij nga të tjerët ka qenë se Ai ka marrë shpallje nga Allahu famëlartë dhe se ka qenë i dërguar si një pejgamber dhe si shpallës i fesë Islame. Kuran'i famëlartë na flet në mënyre të qartë për pejgamberin, misionin dhe vendin e tij tek njerëzit. Ai ka qenë i frymëzuar me shpallje hynore, i edukuar nga ana e Allahut xh.sh. dhe ka qenë për besimtarët shembulli me i lartë (Ahzab, 21). Në këtë rast, obligimet e Muhammedit (a.s) sipas Kuran'it famëlartë mund të radhiten në këtë mënyrë:

1. Dëshmia

Allahu xh. sh. thotë: " Vërtetë që ne ju kemi dërguar juve të Dërguar (Muhammedin a.s) për të qenë deshmues mbi ju, ashtu sic dërguam të dërguar (Musain) te Faraoni". (Muzzemmil, 15) "O Pejgamber (Muhammed a.s) me të vertetë që ne të kemi dërguar ty dëshmues, përgëzues dhe këshillues". (Ahzab, 45; Fet'h, 8)

Sipas kësaj, Muhammedi (a.s) si një pejgamber është dëshmues i së vërtetës dhe i shpalljes. Si para, ashtu edhe pas profetësisë, me personalitetin e tij të pashoq, me vetëqëndërimin e tij, ai është dëshmues i shpalljes.

Sipas Mevdudit, kuptimi i ardhjes së Pejgamberit (a.s) si një dëshmues, përgëzues dhe këshillues, do të thotë se ai është dëshmues i së vërtetës në këtë dynja si me fjalë ashtu dhe me vepra. (Mevdudi 6, 503)

Pejgamberi a.s është dëshmues për zbatimin e obligimeve të Allahut xh.sh. dhe se jashtë këtyre, të gjitha tjerat janë të pavlefshme. Këto obligime, Pejgamberi (a.s) i zbatoi vetë më së pari, sjellja dhe karakteri i tij dëshmonin se sa i sinqertë ishte në misionin e tij.

Personaliteti i tij duhet të jetë i pashoq, ashtu që kur të shohë Atë, njerëzimi të mund të kuptojë me anë të personalitetit të tij pashoq se çfarë sjellje kërkon të vendosë tek njeriu dhe cili duhet të jetë botëkuptimi i tij.

2. Qortimi

Muhammedi (a.s), ashtu si edhe pejgamberët e mëparshëm, është një qortues i qartë. (Dharijat, 50; Neml, 56) Në misonin e Pejgamberit (a.s), një ndër obligimet e para të kërkuara prej tij është qortimi. Në fillim të shpalljes, Pej-

gamberi (a.s) mbulohet për shkak të emocioneve të shpalljes, urdhërohet sërish me shprehjen: "Ngrihu dhe qorto" (Muddeththir, 1).

Pikësëpari, obligimi ka qenë të këshillonte familjen e tij, (Shuara, 214) pastaj tërë Mekkaset dhe njerëzimin anembanë. Në këtë mënyre, Pejgamberi (a.s) ka qortuar njerëzimin me Kuran'in famëlartë dhe me dënim të Ahiretit për ata që nuk besojnë.

3. Përgezimi

Mes obligimeve të Pejgamberit (a.s) që përmenden në Kuran'in famëlartë, është misioni i përgëzimit të besimtarëve me Xhennet. Allahu xh. sh. thotë: **Vërtetë Ne të kemi dërguar ty me të vërtetën (e Islamit), përgëzues (për ata që besojnë) dhe paralajmërues (me xhehennem për ata që nuk besojnë)** ... (Bekare, 119)

Në shumë ajete kuranore përmendet se ata që besojnë, bëjnë vepra të mira; për durimtarët e për të devotshmit ka përgëzime me shpërblime të ndryshme të Xhennetit. (Bekare, 25, 155, 223) Allahu xh. sh. thotë: (Këta janë ata) që pendohen (për mëkatet e tyre), që e adhurojnë (Perëndinë), dhe e falenderojnë Atë, dhe agjërojnë, dhe bëjnë ruku e sexhde, (falin namazin), urdhërojnë bërjen e veprave të mira, e pengojnë prej të këqijave dhe të cilët ruajnë dispozitat e Perëndisë. E sihariqoji besimtarët! (Tevbe, 112)

4. Këshilla

Muhammedi (a.s) është obliguar si Pejgamber të këshillojë myslimanët, sepse këshilla ndikon për të mirë tek një mysliman dhe këshilla më e mirë është të recitosh ajetet Kuranore, të cilat janë në formën e këshillës, që t'i përkujtojnë ato ajete. Allahu xh.sh. thotë: Ftoji (njerëzit o Muhammed) në udhën e Zotit tënd, me urtësi dhe me thirrje të ndershme e të bukur dhe bisedo bukur me ta, në mënyrën më të mirë. (Nahl, 125)

5. Thirrja Islame

Thirrja Islame është një ndër obligimet më të rëndesishme të Pejgamberit (a.s) e përbën edhe shkakun kryesor të ardhjes së Tij. Allahu e shpjegon qartazi misionin e Pejgamberit (a.s), duke thënë: "O Pejgamber, Ne të kemi dërguar si dëshmitar, dhe si sihariques dhe si paralajmërues; dhe thirrës (në rrugën e drejtë) te Perëndia – me urdhërin e Tij dhe që të jeshë kandil ndriçues. (Ahzab, 45-46)

Pejgamberi (a.s) në thirjen islame ka ndjekur një rrugë të pandërprerë dhe përcjellëse, aq sa kjo lodhje e Pejgamberit (a.s) është përmendur në Kuran'in famelartë. Allahu xh.sh. thotë: "A mos vallë ti (o Muhammed) don ta shkatërrosh veten, ngase ata nuk duan të besojnë?" (Shuara, 3). Po ashtu, është kërkuar nga Ai të jetë i durueshem ndaj torturave të mosbesimtarëve, sepse nën hijen e vahjit shihet qartë se misioni i Pejgamberit (a.s) është një strategji hynore. Për të mbërritur në cakun kryesor, periudha e kaluar, mjetet e përdorura sipas situatës, qoftë për sahabët qoftë për tërë njerëzimin, paraqesin metodën ideale të thirrjes islame.

6. Teblig

Një ndër obligimet e Pejgamberit (a.s) është të përçojë shpalljen e dhënë nga Allahu xh.sh. , aq sa mund të themi se kjo është esenca kryesore e shpalljes. Allahu xh. sh thotë: "O i Dërguar (Muhammedi a.s), shpalle (mesazhin) i cili të është zbritur ty nga Zoti yt, dhe nëse nuk e bën këtë, atëhere nuk e ke shpallur mesazhin e Tij.. (Maide, 67)

Aisheja (r.a) përcjell se ata që thonë se Pejgamberi (a.s) i është shmangur diçkaje nga Kurani famëlartë, kanë gënjyer, sepse ajo mbështetet në këtë ajet Kuranor. (Buhari, Tefsir, 5) Nuk është në dorën e tij të ndryshojë diçka ose të shtojë sipas dëshirës së tij, sepse ai është vetëm transmetuesi i fjalëve te Krijuesitë dhe ndjekësi i asaj që shpallet nga Allahu xh.sh. Sa i përket sahabëve, ata kanë dëshmuar se i Dërguari i Allahut ka kryer obligimin e tij dhe e ka përhapur shpalljen e Allahut.

7. Tilavet

Një ndër obligimet e Pejgamberit ka qenë që ajetet dhe suret e zbritura t'i transmetonte nëpërmjet leximit të Kuranit. Duke qenë se Pejgamberi (a.s) ishte një njeri i zakonshëm dhe s'e dinte çka ishte libri, imani, dhe duke mos pritur t'i vinte shpallje, dëshira e Allahut e zgjodhi Muhammedin a.s t'u recitonte njerëzve ajetet kuranore. Një ndër obligimet kryesore të Pejgamberit, të cilat janë përmendur në Kuran, është edhe leximi i ajeteve dhe i sureve.

8. Bejan (sqarimi)

Ai ka qenë i obliguar edhe të sqarojë ajetet Kuranore: Allahu xh. sh. thotë: (I kemi dërguar ata) me argumente të qarta dhe libra. Dhe Ne, ty ta kemi dërguar Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve dispozitat e shpalljes, dhe që ata të mendojnë. (Nahl/44)

Sqarimi i ajeteve nga ana e Dërguarit ka qenë sqarimi i normës së një sendit ose sqarimi i një ajetit të paqartë, ose sqarimi i një ajetit mubhem ose mucmel. Përvec këtyre obligimeve të Pejgamberit (a.s), mund të përmendim obligimin e zbatimit (tatbik) nga ana e njerëzve të ajeteve të zbritura dhe i dhënies normë (teshri') ndonjë sendi, që nuk i ishte dhënë më parë.

Letër Resulullahut

-sal-lallahu alejhi ue sel-lem-

Paqja dhe mëshira e Allahut të Madhëruar qofshin mbi ty o i Dërguar i Allahut,
zë i së vërtetës, mëshirë për botët, paralajmërues i njerëzimit dhe përgëzues i udhëzimit.
Bugeta e dritës që largon errësirën e mosbesimit dhe që ndriçon rrugën tonë.
Po të thërras si shokët e Tu të bekuar: "Të qofshin falë nëna dhe babai!"
Malli për ty po ma copëton zemrën.
O i Dërguar (a.s)!

Mbase nuk e pashë fytyrën që xhelozoi hënën
dhe bukurinë e buzëqeshjes që ngroh zemrën e njeriut.
Mbase nuk ta dëgjova zërin,
i cili ishte qetësi dhe udhëzim për zemrat dhe thirrës për në xhennet.
Mbase nuk t'u gjenda pranë në Bedir, në Uhud, në Hendek
dhe në haxhin e lamtumirës në Qabe.
Mbase nuk ta shtrëngova dorën e bekuar për të të dhënë besën në Akabe.
Nuk munda të të ndihmoja kur armiqtë thurrnin kurthe në Mekke dhe Medine.

Mirëpo, përsëri, malli për Ty po ma djeg zemrën si prush.
O i Dërguar mbi të Dërguarit (a.s)!
Jam i mërzitur, i dëshpëruar dhe zemra ime digjet.
A e di përse?
Sikur malli im të ishte vetëm për të shkuarën,
mbase malli për Ty që më ka mbërthyer shpirtin nuk do të më digjte kaq shumë.
Mirëpo, o i Dërguar (a.s), që kur ke ikur Ti, në këtë botë nuk ka ngelur shenjë mëshire;
Shejtani me shokët e tij na ka rrethuar të gjithëve.

Në tokat tona të cilat i begatove me paqe dhe mirësi, rrodhi lot dhe gjak.
A e do vajtimin që del prej meje, Palestinës, Kashmirit, dhe Afganistanit !..
A e di o i Dërguar (a.s), se ç'ndodhi pas teje në këto toka?
U kryen shumë vrasje, u përjetuan shumë syrgjynosje, u bënë shumë mizori.
Zotat që ti theve, u rindërtuan përsëri një e nga një
dhe përsëri dolën në skenë perëndi të rreme.
Sumejjet, Fatmat dhe Zejnepet u detyruan të qajnë.
U vu dorë mbi mbulesën, simbolin e tyre të ndershmërisë...
Si mos të digjet zemra ime, O i Dërguar, si mos të copëtohet !
O Krenaria e Gjithësisë (a.s)!

Sot, kemi nevojë më shumë se kurrë, për thirrjen tënde që jep jetë,
Mbikëqyrjen tënde të drejtë,
Komandën tënde që të çon në udhëzim,
Dhe patjetër, për shembullin tënd.
Ti që ishe një Kur'an që ecën, Ti që kishe një moral të lartë,
Më fal. Nuk më takon mua të të lavdëroj kur të ka lavdëruar Zoti i Gjithësisë.
O i Dërguar i Allahut (a.s)!

Para teje jam i turpëruar, nuk kam fytyrë të shoh fytyrën Tënde.
Sepse nuk i dola dot për zot amanetit që ke lënë.
S'munda ta marr shembull siç duhet prej moralit tënd të lartë, të qënit një Kur'an që ecën,
qëndrimit tënd të ashpër ndaj të padrejtëve dhe mëshirues ndaj besimtarëve.
Mirëpo, megjithë këto, kam shpresë të vazhdoj në rrugën tënde dhe të eci në hapat e Tua.
Sepse të dua,
E dua atë që të do Ty.
O i Dërguar (a.s)!
Si një zemërdjegur i ummetit tënd të kohës së fundi, të dërgoj salavate sa numri i grimcave të mia.
Paqja qoftë mbi Ty, mbi familjen Tënde dhe mbi shokët e Tu...
Paqja qoftë mbi idealin tënd të shenjtë, nën hijen e të cilit jam strehuar dhe me dashurinë e të cilit jam ngushëlluar.

Mag. Ali Bardhi

Jeta e Daut Boriçit sipas dokumenteve osmanë

Daut Boriçi qe djali i Mustafa Rëfkë (Refik) efendisë, doganierit të Shkodrës. Lindi në Shkodër me datë 7 dhjetor 1826 (7 xhumadel vel 1242).[1] Paraardhësit e tij që njihen janë Molla Hysejn Boriçi / Molla Rexheb / Molla Salih / Haxhi Mustafa Boriçi.

Në veprën e Ali Emirit bëhet fjalë edhe për të vëllanë e tij Halil Nexhib efendi Boriçin.[2] Studiuesit shqiptarë që janë marrë me këtë personalitet ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me prejardhjen e mbiemrit që mori kjo familje. Sipas Hamdi Bushatit, familja Borici u pat vendosur në fshatin Boriç të kazasë së Tivarit nga malësia e Shkrelit, nga ku qe larguar për çështje gjaku. Nga ky fshat morën edhe emrin e fisit me të cilin u njohën kur u vendosën në Shkodër. Ndërsa sipas Vehbi Balës familja këtë emër e morri nga fshati Boric që ndodhen ende pranë qytetit të Shkodrës.

Babai i Daut Boriçit, Mustafa Boriçi pat qenë sekretari i Mustafa Pashë Bushatit, ndërsa më pas u emëruar si doganier i doganës së Shkodrës.[3] Në ditarin e tij Davut efendiu flet për pronat e familjes, për një pyll që i ati bashkë më të vëllanë e tij kishin blerë në fshatin Hus, për një pyll në Golem dhe për arat e familjes në fshatrat Vrakë dhe Vukatanë.[4]

Davut efendiu pati pesë fëmijë.[5] Ata quheshin Junuz, Musa, Mustafa, Sylejman dhe Abdyselam Ahmed. Të dhëna në arkivin e Stambollit janë gjetur vetëm për dy bijtë e tij të fundit Sylejmanin dhe Abdyselamin.

Sylejaman Tevfiku lindi me datë 13 maj 1868. Pasi mbaroi shkollën ruzhdije të Shkodrës filloi nga jeta e nëpunësit që në moshën 16 vjecare si sekretar në Sekretariatin e Këshillit të Vilajetit të Shkodrës. Më pas punoi në zyrën e Llogaritarit, ndërsa në vitin 1892 u ngrit në detyrë si nëpunës i Ambarit dhe Sendeve të Doganës Qendrore të vilajetit të Shkodrës.[6]

Abdyselami lindi me datë 5 korrik 1866. Pasi mbaroi shkollat sibjan dhe ruzhdije edhe ai si vëllai punoi si nëpunës në zyrat e Doganës qendrore të vilajetit të Shkodrës.[7]

Një nga djemtë e Daut Boricit quhej Musa. Në ditarin e tij Daut Borici shkruan se Musai punonte si mësues në shkollën ruzhdije të shkodrës.[8]

Mes viteve 1834-1841 Daut Boriçi mësoi persisht dhe bukurshkrim në sibjan, ndërsa mes viteve 1841-1850 ai mësoi gramatikë dhe sintaksë arabe, logjikë, retorikë dhe drejtësi në medresenë e Shkodrës. Në vitin 1849 ai mësonte gjuhë të huaj dhe shkenca teologjike në medresenë e Qafës nga hoxhallarët e njohur të kohës Salih efendiu, molla Ahmet Hadri dhe molla Sylo Faku. Përveç gjuhës së nënës, shqipes, ai njihte edhe gjuhët arabe, turke dhe persiane.[9]

Me datë 26 maj 1848 ai caktohet imam i xhamisë së Draçinit dhe prej asaj kohe njihet në mesin e njerëzve edhe si molla Dauti. Pas dy vitesh punë si imam në vitin 1850 shkon në Stamboll dhe regjistrohet në medresenë e plumbit në lagjen Fatih, ku nga mësuesi i njohur Sejit Hafiz efendiu mëson lëndët metodologji, aritmetik, gjeometri, filozofi, gjeografi dhe lëndë të ndarjes së trashëgimisë (feraiz). Në vitin 1857 merr mësime nga mësuesi tjetër i njohur i kësaj medreseje Ali Gjakova, nga i cili arriti të marr dy ixhazete. Pasi del me sukses në provimin e fundit me datë 18 mars 1857, Daut Boriçi regjistrohet në Darulfunun nga i cili diplomohet me sukses.[10]

Pasi përfundon edukimin e duhur Daut efendiu fi-

1. BOA, DH. SAID. 26/127
2. Hakan T, KARATEKE, Iskodra sairleri ve Ali Emiri"nin Diğer Eserl - ri, s. 161
3. BOA. DH. SAĠD. 26/127;
4. Daut Boriçi gunlugu, 2, 6
5. BOA, MF. MKT, 51/46
6. BOA. DH. SAĠD. 31/102
7. BOA. DH. SAĠD. 165/23; BOA. DH. SAĠD. 471/31.
8. Daut Boriçi gunlugu, 65
9. BOA, DH. ŞAĠD. 26/127
10. BOA. DH. SAĠD. 26/127

llon detyrën si mësues në Anadoll, por më pas vendos të kthehet në Shkodër, gjë që realizohet kur ai gjen kërkesën e një nëpunësi tjetër për ndërrim vendi të detyrës. Para se të kthehej ai takohet me Riza beun, djalin e Mustafa pashë Bushatit. Mes të tjerash në marrjen e këtij vendimi mund të ketë ndikuar edhe reforma e madhe centralizuese që nisi të zbatojë perandoria osmane, e cila përfshinte edhe shkollat që tani do të fillonin të drejtoheshin nga organet qendrore.

Në vitin 1858 në Shkodër u çel shkolla ruzhdije në pazarin e vjetër. Me datë 18 qershor 1857 Daut efendiu u emërua si mualimi i parë në ruzhdijen e vilajetit të Shkodrës me një rrogë prej 750 kurushësh, kur ishte në moshën 32 vjeçare.[11] Në diplomat e para që u shpërndanë për nxënësit e kësaj shkolle në vitin 1861 gjendej edhe firma e Daut Boricit i cili vazhdoi të japë mësim në këtë institucion arsimor deri në vitin 1867.

Me datë 3 qershor 1869 Daut Boriçi caktohet si kryetar i komisionit për organizimin e rrethprerjeve (synetllëkut) tek meshkujt e malësisë. Në ditarin e tij Daut Boriçi tregon rreth sasisë së parave që kishte marrë nga zyra e financës së vilajetit për rrobat e qepura që do tu dhuroheshin fëmijëve që do të bëheshin synet në zonat e Dukagjinit.[12]

Përkrah këtyre detyrave Daut efendiu caktohet me datë 26 maj 1872 edhe kryetari i komisionit për përgatitjet në vilajetin e Shkodrës së objekteve që do të ekspozoheshin në ekspozitën e madhe që u hap atë vit në Vjenë.[13]

Në vitin 1870 Daut efendiu caktohet në detyrën e inspektorit të arsimit për vilajetin e Shkodrës duke ju caktuar një rrogë prej 2000 kurushësh.[14] Me datë 23 nëntor 1880 Ministria e Arsimit e fton në Stamboll dhe pas një reforme në arsim e emërojnë në inspektoratin e shkollave iptidaije dhe ruzhdije për Anadollin, duke i caktuar një rrogë prej 1500 kurushësh.[15]

Më pas ai emërohet me një rrogë prej 1500 kurushësh në inspektoratin e këshillit që varej nga zyra arsimore dhe më pas emërohet drejtor i shkollës së vajzave (darul-muallimat).[16]

Në këtë detyrë ai nuk vazhdoi një kohë të gjatë, sepse me vdekjen e së shoqes fëmijët i mbetën pa kujdesin e prindit, prandaj iu desh të vendosej në Shkodër. Në vitin 1883 u caktua në drejtorinë arsimore të vilajetit me një rrogë prej 2000 kurushësh, gjysmën e së cilës ia pagonte shteti, ndërsa gjysma tjetër mbulohej me të ardhurat e shtetit.[17] Sipas dokumentit arkivor e shoqja i vdiq nga rrufeja.[18]

Gjatë një jete kaq të pasur arsimore, politike dhe kulturore Daut Boriçi u dekorua me disa dekorata. Kështu në vitin 1863 ai u dekorua me dekoratën e luftës Turko-Malazeze.[19] Pas disa vitesh me datë 21 tetor 1866 ai u dekorua me dekoratën e myderisit Edirne Ibtidai Harixhi. Me datë 30 shtator 1876 atij i jepet dekorata osmani, ndërsa me datë 2 mars 1893 dekorohet me dekoratën nishani mesxhidi të rangut të katërt.[20]

Në fund të jetës së tij duhet edhe të ketë në haxh. Dokumentet nuk flasin qartë për një gjë të tillë, përveç faktit që në një dokument të vitit 1899 ai përmendet si "haxhi Daut Shykri". Fakti që ky dokument është hartuar pas vdekjes së tij, na lejon të supozojmë që është një burim indirekt që tregon se Daut Boriçi mund të ketë shkuar në haxh.[21]

Në detyrën si inspektor i arsimit Daut Boriçi vazhdoi deri në vitin 1896. Më pas ai u nxor në pension. Pas këtij vendimi të ministrisë së arsimit, valiu i Shkodrës, Abdullah beu i shkroi kësaj ministrie në mënyrë që Daut efendiu të caktohej sërish në detyrë, sepse megjithëse e kishte mbushur moshën ai ende gëzonte shëndet të mirë dhe kishte ndikim mi njerëzit. Në një shkresë tjetër të firmosur nga populli, partia dhe dijetarët e Shkodrës kërkohet që Daut Boriçi të kthehet sërish në detyrë pasi që nxjerrja e tij në pension ka qenë një lëvizje e padrejtë.[22]

Burimi i vetëm që flet rreth datës së vdekjes së Daut Boriçit është orientalisti i njohur Hamdi Bushati i cili jep datën 3 nëntor 1896 (16 xhumadelahir 1312). Kjo e dhënë duket e dyshimtë pasi në një shkresë të datës 27 ramazan 1314 (1898) mësojmë se Daut Boriçi, i dalë në pension i kishte dërguar një shkresë ministrisë së Arsimit.[23] U varros në varrezën e Luguçesmës, aty ku qe varrosur më parë edhe e shoqja. Asgjësimi pa kriter i gurëve të kësaj varreze gjatë punimeve urbanistike gjatë sundimit komunist në Shqipëri bën që të humbiste edhe guri i varrit të tij.

11. BOA. DH. SAĠD. 26/127
12. Daut Boriçi gunlugu, 48
13. Daut Boriçi gunlugu 7, 130
14. BOA. DH. SAĠD. 26/127
15. BOA. DH. SAĠD. 26/127;
16. BOA, DH. SAĠD. 26/127
17. BOA. DH. SAĠD. 26/127
18. BOA. NF. MKT. 81/46.
19. BOA. DH. SAĠD. 26/127
20. BOA. DH. SAĠD. 26/127
21. BOA. MF. MKT. 471/31.
22. BOA. MF. MKT. 248/51
23. BOA, MF. MKT. 331/34

Nëse je i denjë për vajzën time, VËRTETOJE!

Alaeddin Muhammed Samerkandi, një nga zërat më të rëndësishëm të dijetarëve Hanefi që kanë jetuar në kohën e Karahanllëve, u lind në Samerkand më 1073 dhe studioi në Buhara. Ndër nxënësit më të suksesshëm që Samerkandiu ka përgatitur në aktivitetin e tij, vijnë e bija Fatma dhe dhëndërri Ebubekir el-Kasani. Samerkandiu, i cili vdiq në Buhara më 1144, ishte një dijetar me zë në usul dhe kelam; ai konsiderohet ndër autoritetet më të mëdha në shkollën Maeveraunnehir Samerkant. Vepra " Tuhefetu'l-Fukeha" që ai shkroi, përmendet si një ndër veprat më të rëndësishme në fushën e fikhut. Duke u mbështetur në veprën në fjalë, dhëndërri i tij Kasani, shkroi më pas veprën "Bedaiu's-Sanaji".

Nxënësi i Samerkandiut, Ebubekir el-Kasani, i cili i kishte tërhequr vëmendjen shpesh me zellin dhe devotshmërinë e tij, një ditë kërkoi dorën e Fatmës, vajzës së hoxhës.

Përgjigja e hoxhës ndaj kërkesës së nxënësit të tij të tërhiqte vëmendjen: "Duhet të jesh i përafërt në dije me vajzën time, nëse ke menduar të kërkosh dorën e saj dhe këtë unë nuk mund ta di…"

Kjo fjalë i erdhi rëndë Kasanit, i cili e pyeti menjëherë:

"Zotëri! Cfarë dëshironi të bëj për t'ju treguar nëse jam apo jo i denjë për vajzën tuaj?"

Përgjigjja e Samerkandiut ishte gati:

"Nëse bën shpjegimin e Tuhfetu'l- Fukaha-së dhe arrin ta bësh edhe vajzën time Fatma që ta pëlqejë këtë, atëherë unë do jem i detyruar të pranoj kërkesën tënde."

Kësisoj, i riu Kasani u detyrua të mos njihte më ditë e natë dhe të punonte shumë për të hedhur në dritë veprën e njohur "Bedaius'-Sanaji", një kopje e së cilës gjendet sot në bibliotekën e Sulejmanijes. Pasi Samerkandiu vuri re shpjegime të gjëra dhe me vlerë të veprës së vet, ia dorëzoi edhe të bijës, që ta vlerësonte edhe ajo. Edhe e bija e cila ishte një dijetare në fik'h, e pëlqeu veprën. Nxënësi i ri fitoi kështu të drejtën të martohej më vajzën e hoxhës, Fatmën.

Kjo është edhe arsyeja që shpesh në tubimet e dijetarëve thuhej shprehja:

"Shpjegoi Tuhfe-në e hoxhës së tij dhe i mori vajzën." Gjithashtu përmendet se Samerkandiu e pëlqeu aq shumë veprën e nxënësit aq sa e pranoi atë si mehër për vajzën e vet Fatma, dijetare në fushën e fik'h-ut.

Fatma binti Hattab (r.a.) simbol i guximit dhe i kurajos!

E karakterizuar nga durimi dhe këmbëngulja në Islam, ajo bëhet shkak për nxjerrjen e Hz. Omerit, vëllait të saj, nga errësira e injorancës. Është gruaja e Said bin Zejdit (r.a), i cili që në gjallje u lajmërua nga Profeti (s.a.s) se do ishte ndër banorët e xhennetit. Hz. Fatma lindi në Meke dhe është vajza e Hattab ibni Nyfejl. Pasi pranoi islamin, ajo u mundua gjithnjë të ujiste pemën e imanit, duke kënduar ajetet kur'anore të cilat ia kishin pushtuar zemrën. Transmetonte gjithnjë tek të tjerët shembuj dhe modele nga jeta e të Dërguarit (s.a.s). Hz. Fatma, po ashtu edhe i shoqi Saidi (r.a), megjithëse qenë ndriçuar me dritën e Islamit, ishin të detyruar ta mbanin atë fshehurazi. Ajo frikësohej gjithnjë nga acarimi i mundshëm i të vëllait Hz. Omerit, që ishte ndër djemtë më krenarë, më të ashpër, më të fortë, më sypatrembur të kurejshëve, arsye për të cilën kurejshët e kishin vendosur në radhën e armiqëve më të mëdhenj të Profetit të mëshirës (s.a.s).

Ishte koha kur Islami po përhapej me vrull përherë e më tepër, ndërsa Hz. Omeri nuk e kishte marrë ende lajmin i cili do ta trondiste pa masë: faktin që motra dhe kunati i tij kishin pranuar Islamin. Kudo nëpër rrugët e Mekes ishin shtruar këmbëkryq torturat dhe mundimet që politeistët u shkaktonin muslimanëve, por këta, me një durim dhe bindje të palëkundur nuk hoqën dore nga rruga e drejtë dhe synimi që i kishin vënë vetes, duke e konsideruar këtë botë si mjet për të fituar ahiretin. Për këtë arsye, numri i besimtarëve shtohej gjithnjë e më tepër dhe askush prej tyre nuk e braktisi besimin për t'u kthyer sërish në injorancë. Drita e besimit po depërtonte tek njerëzit dhe fuqia e Islamit po çlironte nga injoranca zemra të reja. Të ndodhur para një gjendje të tillë, mushrikët organizuan një tubim, në të cilin do vendosej një herë e mirë fati i muslimanëve, që dita-ditës po shijonin mirësitë e besimit. Vendimi i kësaj mbledhjeje ishte tejet rrënqethës dhe i prerë: "Të vritej Muhammedi"! Sa për personin që do të realizonte këtë akt, ai do të shpërblehej me shumë të mira materiale. Duke qenë i pranishëm në mbledhje, Hz. Omeri ngrihet hijerëndë në këmbë dhe e merr përsipër vetë këtë detyrë. Përgatit shpatën dhe niset drejt vendit ku ndodhej Profeti (s.a.s). Por rrugës mëson lajmin që do ta trondiste shumë: faktin që motra dhe kunati i tij kishin pranuar islamin. I verbuar nga injoranca, ai niset së pari në shtëpi për t'i dhënë fund jetës së tyre. Teksa po i afrohej shtëpisë, ai dëgjon disa ajete kur'anore. Hap derën me vrull dhe pyet i inatosur: "Çfarë ishte ajo që po lexonit? Mora lajmin që keni pranuar fenë e Muhammedit. Tashmë do pranoni edhe fundin e jetës tuaj!". Hz. Fatma, motra e tij, me një guxim dhe kurajo të pashembullt i doli para atij heroi sypatrembur nga hija e të cilit frikësoheshin shumë kurejshë, dhe i tha: "Omer! Omer!...Tashmë ne kemi pranuar Islamin dhe kemi deklaruar se nuk ekziston Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij, ndaj me bindje ne nuk do kthehemi kurrë nga kjo rrugë...Urdhëro, bëj ç'të duash". Këto fjalë plot guxim të së motrës, e zbutën zemrën e Omerit, i cili kërkoi edhe një herë të dinte se çfarë ishin duke lexuar në kohën kur ai ishte duke hyrë në shtëpi. Hz. Fatma filloi menjëherë të lexonte ajetet e para të sures Taha: " Taha. Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të të munduar ty. Ta shpallëm vetëm këshillë për ata që frikësohen. Shpallje nga Ai që krijoi tokën edhe qiejt e lartë. Ai është mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë....." (Taha 1-16). Madhështia e fjalëve hyjnore e futën Hz. Omerin në mendime të thella. Filluan të shëndritnin rrezet e para të bindjes në zemrën e tij. Ai iu drejtua motrës me fjalët "Ç'janë këto fjalë madhështore, plot kuptim?". Dhe me të deklaruar Shehadetin, ai u nderua me fenë e Allahut, Islamin.

Ishte pikërisht qëndrimi sypatrembur, bindja, forca e besimit, kurajoja e Hz. Fatmës, ajo që arriti të zbuste një zemër plot inat dhe mllef, duke hyrë në histori e përmendur në radhët e grave më heroina. Ky qëndrim heroik, vendosmëria, sakrifica, zgjuarsia, devotshmëria, do ta shoqëronin Hz. Fatmën gjatë gjithë jetës së saj. Ajo Kreu hixhretin (emigrimin nga Meka në Medine) me të shoqin dhe vdiq po në Medine në përiudhën kur Hz. Omeri ishte halif.

Shkencëtarët shpresojnë se kanë zbuluar molekulën që do të mund të bllokojë HIV-in

Një ekip shkencëtarësh amerikanë kanë zbuluar një molekulë që mund të bllokojë transmetimin e virusit HIV, që shkakton SIDË-n. Studiuesit thonë se në të ardhmen mundet të përdoret një krem i përbërë nga një agjent lokal, për parandalimin e infektimit me virusin vdekjeprurës.

Shkencëtarët e dinë prej një kohe të gjatë, se pasi virusi HIV hyn në trupin e njeriut, ai lufton për të qëndruar atje. Por një proteinë e cila gjendet në formë natyrale, tek sperma e meshkujve, e njohur si SEVI, e bën virusin 100 mijë herë më infektues se sa do të ishte normalisht, duke e ndihmuar më tej aftësinë e virusit HIV për t'u lidhur me qelizat e bardha të viktimës. Kjo çon në shkatërrimin e sistemit imunitar të trupit të prekur nga virusi.

Tani, kërkuesit amerikanë kanë zbuluar se një molekulë të quajtur surfen, ndërhyn në veprimin e SEVI-it. Warner Greene është drejtor i Insitutit Gladstone të Virologjisë dhe Imunologjisë në San Fransisco të Kalifornisë, ku janë kryer studimet laboratorike.

"Zbuluam se kjo molekulë e vogël e quajtur surfen, mund të bllokojë lidhjen e SEVI-t, duke u lidhur me virusin HIV, duke ndaluar kështu ciklin e infektimit, ose atë të transmetimit".

Studiuesi Greene thotë se molekula surfen, fillimisht e njohur nga shkencëtarët në vitin 1939, është një agjent njëkohësisht anti-iflamator dhe anti-bakterial. Ai shpjegon se surfeni parandalon infektimin duke u lidhur si me virusin e SIDË-s, edhe me qelizat e gjakut, që janë vënë në objektivin e virusit HIV.

Kërkimet për mjekimet lokale, të njohura si microbicide, që janë kremra dhe substanca xhelatinore të cilat përmbajnë agjentë kundër SIDË-s, dhe përdoren zakonisht para marrëdhënieve seksuale, kanë qenë të pasuksesshme. Kjo metodë nuk ka qenë e efektshme në parandalimin e përhapjes së virusit të SIDË-s. Por zoti Greene shpreson se molekula surfen do të jetë e efektshme.

"Mendoj se koncepti i shfrytëzimit të agjentëve që punojnë jo vetëm tek virusi, por edhe tek faktori bartës i tij, që nxit infeksionin, mund të prodhojë një bashkëveprim të fuqishëm që mund të jetë i efektshëm".

Zoti Greene thotë se terapi të ngjashme të kombinuara, të ashtuquajtura "kokteil", janë provuar të jenë armë të efektshme në trajtimin e pacientëve të prekur nga SIDA.

"Ashtu sikurse përdorim kombinimin e terapisë antiretrovirale për trajtimin e pacientëve të infektuar me virusin HIV, ne mund të jemi të aftë të parandalojmë transmetimin e virusit, përmes përdorimit të kombinimit të mikrobicideve".

Studiuesi Warner Greene dhe kolegët i përshkruajnë vetitë anti-SIDË të molekulës surfen në numrin e fundit të Revistës së Biokimisë.

Shqetësimi dhe stresi i provimeve ndikon në kujtesë

Shkencëtarët paralajmërojnë për shqetësimin e nxënësve gjatë sezonit të provimeve. Presioni i prindërve dhe stresi provimeve tek disa nxënës për disa orë ndikon në mos funksionimin e kujtesës. Zgjidhja e saj është të qetësia dhe një gjumë i rehatshëm.

Gjatë zhvillimit të provimit është më se normale që nxënësi të ketë shqetësim,por ky shqetësim nuk duhet te kalojë në nivel paniku. Paniku ndikon për disa orë në mos funksionim të kujtesës së tyre. Hormonet e stresit ndikojnë në qendrën e kujtesës, për këtë arsye shqetësimi i tepërt ndikon në mosfunksionimin e kujtesës duke e paralizuar atë.

Stresi dhe shqetësimi i tepërt krijon sëmundje tek njeriu, nga shqetësimi i tepërt kalon gjak me presion në hormone, kështu që hormonet ndikojnë në mosfunksionimin e qelizave. Një rrugë që duhet ndjekur për të pakësuar shqetësimin tek fëmijët është: prindërit duhet ti motivojnë ata kur tek fëmijët lindin mendime negative duke i zëvendësuar me mendime pozitive si psh: po sikur të më pyes mësuesi nga temat që skam mësuar, duke e zëvendësuar menjëherë me “mësuesi do pyes nga temat që ti ke mësuar”.

Pasi ka përfunduar provimi tek të gjithë fëmijët lindin mendime se mos ka marrë not të keqe. Prindërit duhet të flasin me fëmijën për gjithë semestrin duke mos e kritikuar për notën e keqe. Sepse fëmija mund të humbas provimin,por ju mund të humbisni atë

Gjatë sezonit të provimeve edhe dieta është e rëndësishme duke konsumuar fruta dhe perime pasi ndikojnë në uljen e shqetësimit dhe stresit tek fëmija. Duke e shmangur atë nga konsumimi i ushqimit me yndyra , pasi nuk ndikon mirë tek fëmijët.



Google
plane për të dixhitalizuar të gjithë librat në qarkullim

Gjiganti i botës kompjuterike Google, ka në plan që të skanojë të gjithë librat që qarkullojnë në glob, dhe t'i ofrojë ato përmes faqes së vet në internet. Kjo iniciativë mund të sjellë një qasje të pa hasur më parë në koleksionin e diturisë së pafund njerëzore, por ka krijuar kundërthënie të mëdha për sa i përket faktit, se kush do të përfitojë nga ky projekt. Projekti i ndërmarrë nga Google ka ngjallur kritika mes akademikëve, autorëve dhe kompanive rivale të teknologjisë së lartë, disa prej të cilave kanë kryer padi gjyqësore për ta ndalur këtë projekt, ose për ta modifikuar atë.

Një kamion që i përket kompanisë Google, ka ndaluar përpara librarisë së Universitetit të Stanfordit pranë San Franciskos , pak përpara orës 9 të mëngjesit. Ai është i mbushur me libra që kompania Google i mori dhe tani po i kthen, mbasi i skanoi, e kështu ato tashmë mund të hyjnë në sistemin e kompjuterëve. Mbasi kamioni boshatiset, punonjësit e librarisë, e rimbushin me libra të tjerë, të cilat gjithashtu do të dixhitalizohen.

Drejtori i kompanisë për sektorin e librave, Daniel Klansi thotë se pikësynimi është që të skanohen deri në 40 milionë libra.

"Google ka si qëllim që të organizojë të gjithë informacionin e botës".

Përveç Stanfordit, edhe Universiteti i Kalifornisë në Bërkli, dhe Universiteti i Miçiganit kanë nënshkruar marrëveshje që e autorizojnë kompaninë Google të skanojë librat e tyre.

Punonjësi i bibliotekës së Stanfordit, Majkell Keller thotë kjo iniciativë rizgjon interesin e lexuesit për libra të harruar.

"*Ajo që ndodh kur librat dixhitalizohen dhe bëhen të lexueshme në rrjet, është se ata bëhen më të përdorshëm. Është llogaritur se librat mundtë përdoren tani 10 herë më shumë se më parë*".

Avokati Geri Rebak përfaqëson Aleancën e Librit të Hapur, ku përfshihen kompanitë Microsoft dhe Amazon.com. Ai thekson se ndonëse Google, mund të mos vendosë fillimisht pagesa për qasjen online në librat e dixhitalizuar, do të vendosë patjetër më vonë, pagesa të shtrenjta për përdorimin e bibliotekave online.

"Nuk është librari publike, është librari private. Dhe është krijuar për të përfituar, madje shumë. Google do të vendosë tarifat e pagesës në universitete, tek njerëzit e thjeshtë, madje pagesë do të duhet dhe nga fëmijët që do të duan të lexojnë librat përmes Google".

Dixhitalizimi i librave bashkëkohorë, ku e drejta e autorit njihet, nuk sjell debate. Madje as dixhitalizimi i librave të vjetër, për të cilët e drejta e publikimit ka skaduar.

Problemet janë të mëdha me dixhitalizmin e librave që quhen "jetimë" pasi ata janë shtypur, janë ende nën të drejtën e autorit, por nuk njihen personat që kanë të drejtën e publikimit. Shitja e kopjeve dixhitale të këtyre librave mund të jetë fitimprurëse, por pyetja që shtrohet është se kush do të përfitojë nga shitja e këtyre librave.

Google këmbëngul që ky projekt është më i madh se përfitimi në të ardhura.

"Google shpreson që të përfitojë nga ky projekt duke përmirësuar shërbimin e kërkimit në internet. Ne presim që të fitojmë para nga shitja e librave, por motive kryesor nuk është fitimi."

Ndërkaq, Google vazhdon të skanojë librat e bibliotekave që shkarkohen nga kamionët e mbushur me to. Seanca dëgjimore për çështjet ligjore që përfshihen në këtë projekt, është në plan të zhvillohet përpara një jurie federale në muajin shkurt.

Shqipëria përballë sfidës së numërimit të popullsisë së saj!

Qeveria nisi më 14 janar të këtij viti (2010) punën për regjistrimin e popullsisë në vend për herë të parë sipas etnisë dhe fesë. Ministri i Shtetit, Genc Pollo, i cili është edhe drejtuesi i këtij projekti, mblodhi Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave

(REPOBA), për të nisur punën për procesin e regjistrimit, i cili do të nisë në janar të vitit 2011. Në fjalën e tij gjatë mbledhjes, Pollo e konsideroi procesin e regjistrimit të popullsisë si një proces me një rëndësi të jashtëzakonshme që i shërben mirëqeverisjes dhe jep një panoramë të plotë zhvillimeve sociale dhe ekonomike në vend. Sipas Pollos, për herë të parë përmban edhe pyetjen për përkatësinë etnike dhe fetare.

Nga ana tjetër, ministri i Shtetit theksoi se ky proces do të ketë një mbështetje të madhe dhe shumë profesionale nga INSTAT, ekspert të BE-së, si edhe agjenci të tjera ndërkombëtare.

Projekti për regjistrimin e popullsisë është një projekt që, sipas Pollos, ka një kosto të madhe financiare prej 15 milionë eurosh, por ai ka një vlerë të madhe për sa i përket mirorganizimit të politikave sa më të mira qeverisëse.

Regjistrimi i popullsisë mbi baza etnike konsiderohet arritje nga anëtarët e minoritetit etnik grek të Shqipërisë. Madje, ata thonë se kjo është nismë e vonuar dhe se vala e kundërshtimeve që po ndodh këto ditë në media ka nuanca nacionaliste të tepruara. Ndërkohë, për vllehtë, që janë një pakicë etnokulturore, nisma e fundit ka ngritur një pikëpyetje të madhe. Një pjesë e madhe e vllehve të Shqipërisë, për shkak të trajtimit të diferencuar nga Athina, e identifikojnë veten si grekë. Një pjesë tjetër e të njëjtit komunitet e konsiderojnë veten shqiptarë, për sa kohë që të qenit vllah nuk njihet si kombësi nga ligji shqiptar.

Tërmeti në Haiti: Franca kritikon "pushtimin" amerikan!

Tërmeti goditi rreth 10 kilometra nga kryeqyteti Porto Princ. Tërmeti 7 ballë i shkallës rihter u shoqërua me pasgoditje, përfshi një lëkundje që kapi masën 5.9 ballë. Në Haiti situata vazhdon të mbetet e rëndë dhe viktima të tjera nxirren përditë nga gërmadhat, ndërkohë që numri i tyre i është afruar shifrës 200 mijë.

Franca ka kritikuar ndërhyrjen amerikane në Haiti duke thënë se ndihma ndërkombëtare duhet të ketë si synim lehtësimin e fatkeqësive e jo "pushtimin e vendit". Sipas ministrit të Jashtëm francez, Bernard Kushner, zyrtarët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara duhet që të hetojnë në lidhje me rolin dominant të Shteteve të Bashkuara në Haitin e shkatërruar nga tërmeti. Javën e kaluar forcat amerikane kanë refuzuar uljen e një aeroplani ndihmash që vinte nga Franca e që mbarte pajisje spitalore dhe sanitare duke shkaktuar një zemëratë në Paris. Një ditë më pas, avioni ka mundur që të ulet në aeroportin e kryeqytetit të vendit Port-au- Prince, por ndërkohë Franca është ankuar në lidhje me një veprim të tillë. Si pasojë, ministri i Jashtëm francez, Kushner paralajmëroi qeveritë e ndryshme dhe grupet e ndihmës që të mos grinden dhe acarohen me njëra-tjetrën ndërsa përpiqen që t'u vijnë në ndihmë haitianëve pas tragjedisë së javës që shkoi.

Ndërkohë, një tjetër zyrtar i lartë francez deklaroi se çështja është ndihma e jo pushtimi i Haitit. Në një tjetër incident të fundjavës ka pasur ndalime të tjetra të uljeve të avionëve francezë nga ana e amerikanëve edhe pse më pas incidentet janë zgjidhur. Ushtria amerikane kontrollon kryeqytetin e vendit duke qenë ose shumë organe të qeverisë ose janë me numër të përgjysmuar personash, ose nuk kanë dokumentet dhe zyrat për të organizuar veprimet dhe drejtuar vendin në këtë situatë.

Liderët botërorë kanë premtuar dërgime masive asistence dhe ndihmash materiale e njerëzore në Haiti. Bashkimi Evropian dhe vende të tjera anëtare janë ofruar 400 milionë dollarë si emergjencë dhe më pas një asistencë më afatgjatë për Haitin.

ETIKA	MAUZOLE I NJOHUR NGA FOTO	QYTET NË SHQI-PËRI	ARKËTIM (SHQ.)
"TEST de FRANÇA-IS INTERN-ATIONAL"			
SHKRO-NJË FENI-KASE			
AKTORI I NJOHUR, NIKOLSON			
FUTBOLL. YNI, ULIKS / TONI"A" I NGRITUR			
HIDRO-GJEN		ITALIA / PJESË E NJË MEÇI NË BOKS	
ARMATË (SHKURT.)			
QË NUK ËSHTË FETARE			
ZANORJA E PARAFUNDIT / MUNGESË MORALI PANDERSHMËRI		ATA QË BA-NOJNË RË-ZË MALIT / KAM NJOHURI	
SHTETI NË TË CILIN GJINDET MAUZOLEU NGA FOTO			
1501 (ROMAK)			
DY ZANORE		AUTO-MJETI, VETURA / KORNIZË	
NUMRAT "REAL"		KRYEQYTET I LETONISË / PELLGJE PËR GRU-MBULLIM-IN E UJIT	
SHAJAK I HOLLË, ZHGUN			
LLOJ DEVEJE JUG-AME-RIKANE			
INGEMAR STEN-MARK		LANTAN / "RICHMOND ANIMAL LEAGUE"	
LLOJ PE-SHOREJE (SHQ.) / ANËTAR I SENATIT			
TV APARATI			

QYTET NË RUSI	FIGURË STILI-STIKE
AKTORI VENTURA / GJITAR BREJTËS	
MBRET I LASHTË HEBRE / VEGEL PU-NË (SH.P)	
	EMËR MA-SHKULLI / QYTET NË F. RUSE

ETIKA
SHKENCA MBI PAQEN / ZANORJA E PARË
MODERATO-RI, KRASTA / SHKRIMTAR I NJOHUR, HORHE
R. N. / QË NUK ËSHTË I VJETËR

BESIMI NË ZOTIN
HOLLË, JO ASHPËR / QYTET NË INDI (FOTO)
PAZAR I MADH KU EKSPOZO-HET MALLI / "ZORRO"

ELEMENT KIMIK (Rn)
IRIDIUM / DHJETË (TURQ.)
KAFSHË AFRIKANE / POHIM YNI

SOLISTE JONA, FARA
FUTBOLL. ABIDAL / LUTJE FETARE
FUTB. IRA-NIAN, ALI / KUBËZ BIXHOZI

NATRIUM
O. SH. A. / ZANORJA E DYTË
NËNA, MAMAJA / Ë. R.
"BRITISH SUMMER TIME" / AKTORI DE VITO

PËREMËR VETOR / NJËRI NGA PRINDËRIT (PASHQ.)
DY ZANORE

GJITARËT / POSE-DONIM
1000 (ROMAK) / SHTET I LASHTË NË AZI

MINERAL I GJETUR NË SHKRE-TËTIREN ATAKAMA
FLORIRI

Firma ILIRIA sh.p.k. me qendër në Shkodër

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2523565

BOJRA AMERIKANE

BRENDSHME DHE TE JASHTME

INTERIOR & EXTERIOR

SHERWIN Williams
Benjamin Moore Paints
PITTSBURGH AMERICAN STANDARD PAINT COMPANY

Adresat:
Kompleksi Bexhisteni, në Rus / Shkodër
Koplik, Lezhë, Tiranë
së shpejti edhe në Kosovë

Mobil/Cel: +355 (0) 67 2288016
email: ethnic12alb85@yahoo.com

PROGRESI
BOTIME





Adresa Shqipëri
L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi / Shkodër
Tel: +355 69 20 76768 / +355 67 20 86767
e-mail: revistaetika@hotmail.com

Adresa Kosovë
Ardian Zurnaciu / Marash / Prizren
Tel: +377 44 337582
e-mail: orhan_s22@hotmail.com

N.P. "LUX DEKOR" - Prizren

NRB: 80249179, adresa: rr. Tirana p.n. (zona industriale ish - Voqare)
e-mail: luxdekor4@hotmail.com, tel/fax .: + 381 29 242 174, mob.: (vala + 377)&(ipko + 386) 198 709, 141 253

prodhues i KUZHINAVE

rregallave, dhoma të fjetjes, komod

paradhoma dhe të gjitha llojet e orendive shtëpiake dhe zyr

prodhues i KUZHINAVE

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e KUZHINAVE si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve, bën shitjen e materialit - iverëpllaka, mdf, folje për vakumpress, dhe të aksesoarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve - mveshjen me ultrplast - Laminat, si dhe plastifikimin VAKUMPRES - BALLONPRESS te balloreve me folje te pvc-se në dimenzione të kerkuara nga KLIENTI, GRAVIRIMIN e fronteve me makinë CNC, kandimin - qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.

ABI & ELIF 19

PROGRES

INDUSTRIA USHQIMORE - PRIZREN
FOOD INDUSTRY - PRIZREN

Industria Ushqimore
"ABI & ELIF 19"
Zona Industriale rr. Tirana nr. 9.
20000 Prizren, Kosovë
tel&fax: +38129242433
tel&fax: +38129222322
tel&fax: +38129244005
e-mail: info@abielif19.com
http://www.abielif19.com

ABI & ELIF 19
PROGRES
INDUSTRIA USHQIMORE - PRIZREN
FOOD INDUSTRY - PRIZREN